



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2020:170215

Datë: 23.05.2023

Numri i dokumentit: 04314186

A.nr.2081/2020

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË- Departamenti për Çështje Administrative, me gjyqtarin Kreshnik Kaçiu dhe me bashkëpunëtoren profesionale Erbleta Shala, në konfliktin administrativ të paditësve F..S., M..L., XH..K.. nga D., të cilët me autorizim i përfaqëson V. Sh., avokate nga P., kundër të paditurës së parë Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit e Republikës së Kosovës me adresë: Sheshi “Zahir Pajaziti”, nr. 36, Prishtinë si dhe kundër të paditurës së dytë Zyra e Rregullatorit për Energji me adresë në Rrugën “Bekim Fehmiu”, kati i dytë, Prishtinë, me palën e interesuar K.. Energy Sh.p.k. të cilën me autorizim e përfaqësojnë avokatët A.. K. dhe G. V. Nga P., dhe me Ndërhyrësit në anën e paditësve OJQ “P..” dhe G. për S. J. dhe P., të cilët me autorizim i përfaqëson V. Sh., avokate nga P., për shkak të anulimit të vendimeve kontestuese dhe licensave, pas shqyrtimit kryesor publik, me datë 22.05.2023, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET në tërësi si e bazuar padia dhe kërkesëpadia e paditësve F..S., M..L., XH..K.. nga D...

II. ANULOHEN vendimet e të paditurës së parë Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit, si në vijim:

II.1. Leja ujore për HC Belaja, L.U.13, 4981/20, e datës 03.11.2020;

II.2. Vendimi për Leje Ujore për HC Deçani, L.U.14, 4982/20, e datës 04.11.2020;

II.3. Vendimi për Leje Mjedisore për HC Belaja, 19/5837/ZSP, e datës 06.11.2020;

II.4. Vendimi për Leje Mjedisore për HC Deçani, 19/5837/ZSP, e datës 06.11.2020;

II.5. Vendimi për Leje Ujore për HC Lumbardhi II, L.U. me numër protokoli 5058/20 e datës 03.02.2021.

III. ANULOHEN vendimet e të paditurës së dytë Zyra e Rregullatorit për Energji, si në vijim:

III.1. Vendimi V_1303_2020, i datës 12.11.2020;

III.2. Vendimi V_1304_2020, i datës 12.11.2020;

III.3. Licensë për Prodhimin e Energjisë Elektrike për HC Deçani, Li_49/20, e datës 12.11.2020 dhe

III.4. Licensë për Prodhimin e Energjisë Elektrike për HC Belaja, Li_50/20, e datës 12.11.2020.

IV. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Shqyrtimi kryesor në këtë çështje juridike u mbajt në kuptim të nenit 41 të Ligjit për Konfliktet Administrative, me praninë e palëve ndërgjyqëse të ftuara në mënyrë të rregullt.

Paditësit me padinë e datës 04.12.2020 kanë kërkuar anulimin e vendimeve dhe licensave të kontestuara me padi. Pohojnë se Lejet ujore të lëshuara nga e paditura janë në kundërshtim me Kushtetutën dhe Ligjin, se ligji nuk lejon hidrocentral që rrezikon ujin për pije dhe ujitje, se burimet ujore nuk mund ti jipen biznesit privat pa konkurs, përkatësisht pa koncesion. Paditësit poashtu pohojnë se është shkelur parimi i Ligjshmërisë në procedurë administrative si dhe Ligji për Ujërat dhe se arsyetimi i vendimeve të kundërshtuara me padi është i paqartë dhe kundërthënës dhe se në rastin e lejeve të lëshuar është bërë keqkonstatim i fakteve. Sa i përket të paditurës së dytë, pohon se vendimet për licensë mbështeten në lejet ujore dhe mjedisore që vet janë akte të paligjshme dhe se Zyra e Rregullatorit të Energjisë ka dhënë licensat për 40 vjet, ndërsa lejet ujore e mjedisore vlejnë vetëm 5 ose 15 vjet. I propozojnë Gjykatës që të marr Aktgjykim me të cilin aprovohet kërkesëpadia e paditësive si e bazuar dhe anulohen vendimet dhe lejet e të paditurave.

Në seancën e shqyrtimit kryesor, përfaqësuesja e paditësve dhe e ndërhyrësve OJQ “P.” dhe Grupit për Studime Juridike dhe Politike, deklaroi: *“Në padinë e ushtruar nga F.. S. M.. L. dhe Xh. K., janë mbështetur argumentet që vërtetojnë se të gjithë paditësit kanë cilësinë e palës në këtë procedurë duke u bazuar në Ligjin Nr.03/L-2012 për Konfliktet Administrative dhe Ligjin 03/L-025 Për Mbrojtje të Mjedisit, i cili njeh të drejtën e palëve të interesuara dhe publikut që të ngreh padi apo të kërkoj nga gjykata kompetente të mbrojtë të drejtat e veta në rastet e pësimit të dëmit material apo rrezikut të pësimit material që lidhet me çështje mjedisore, përveç argumenteve të parashtruara në parashtrësën për bashkimin e paditësve të cilën e ka aprovuar kjo gjykatë për gjykatën do të shtojmë edhe argumentet si në vijim sa i përket legjitimiteti aktiv të paditësve. Në këtë procedurë të konfliktit administrativ Gjykata Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative me aktvendimin e dt.12.03.2021, ka njohur të drejtën e organizatave jo qeveritare Grupit për Studime Juridike dhe Politike dhe P. që të paraqiten në statusin e ndërhyrësit në bazë të nenit 271 të LPK-së, ku kushdo mund të ndërhyjë në proces Kontestimore që zhvillohet ndërmjet personave tjerë kur ka interes juridik për të mbështetur njërën ose tjetrën palë ndërgjyqëse me të cilën bashkohet në gjykim për të ndihmuar atë. Në paragrafin 1 dhe 4 të nenit 273 ky ligj ka njohur të drejtën e legjitimiteti procedural të palës ndërhyrëse përmes ofrimit të mundësisë së ndërmarrjes së veprimeve procedurale. Për ndërmarrjen e veprimeve procedurale nga ana e ndërhyrësit ekzistojnë 2 kushte kumulative që*

duhet përmbushur, ne vlerësojmë se në rrethanat aktuale të rastit konkret është i pa shmangshëm korrelacioni i ngushtë ne mes dispozitave ligjore të LKA-së dhe LPK-së, në raport me legjitimitetin procedural të palës paditëse përfshirë edhe ndërhyrësit që marrin pjesë. Neni 10 i LKA-së, ju njeh të drejtën e palës në procedurë të Konfliktit Administrativ rrjedhimisht legjitimitetin aktiv edhe etnitetëve që mbrojnë interesin publik përfshirë Organizatat e Shoqërisë Civile i cili përcakton se: "Organi i Administratës Avokati i Popullit, Shoqata dhe Organizatat e tjera të cilat veprojnë në mbrojtje të interesave publike mund të fillojnë konfliktin administrativ", në mbështetje të kësaj konsiderojmë se aprovimi i tyre si palë ndërhyrëse në favor të paditësve nënkupton se pala paditëse (që përfshin edhe organizatat e përmendura) posedojnë legjitimitetin aktiv si rrjedhojë e interesit juridik për ushtrim të padisë për inicimin e konfliktit administrativ. Për më tepër këto dy organizata joqeveritare P. dhe GLPS kanë paraqitur padinë për Konflikt Administrativ për kontestimin e vendimeve në fjalë në datën e njëjtë me paditësit në lëndën A.nr.2089/20.

Pas argumentimit lidhur me legjitimitetin aktiv të palës paditëse do të lëshohemi në elaborimin e kundërligjshmërisë se akteve administrative të kontestuara në mënyrë kronologjike. Në raport me lejet ujore organet shtetërore kanë kryer shkeljet si në vijim: Nuk është respektuar procedura e konsesionimit i cili është detyrim ligjorë që rrjedh nga Ligji Nr.04/L-147 për Ujërat e Kosovës përkatësisht neni 78 i tij. Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinorë i ka dhënë të drejtën e shfrytëzimit të ujit investitorit K.. vetëm me leje ujore duke anashkaluar detyrimin ligjorë për të ndjekur procedurën e konsesionimit neni 70 i Ligjit për Ujërat përcakton se fitimi i të drejtës ujore bëhet në dy mënyra me leje ujore dhe me konsesion, më tutje me nenin 72 dhe 78 të Ligjit për Ujërat përcaktohet qartazi se në cilat raste e drejta ujore fitohet me leje ujore dhe në cilat raste fitohet me konsesion, neni 72 para.1 i Ligjit për Ujërat përcakton se leja ujore lëshohet për nxjerrje të ujit për konsum të përgjithshëm, shkarkim të ujërave të ndotur, ndërtim, rindërtim ose domolim të objekteve dhe pajisjeve që ndikojnë në regjimin ujqorë, aktivitetet e minierave dhe punimeve gjeologjike të cilat ndikojnë në regjimin e ujërave për hulumtime hidrogjeologjike dhe grumbullim të të dhënave, eksplautimin e rërës, zhavorrit, gurit dhe arxhilit, përdorimi i ujërave për shfrytëzim të energjisë elektrike dhe gjeotermale dhe aktivitetëve tjera që ndikojnë në regjimin ujqorë. Neni 78 i Ligjit për Ujërat në par.1 thotë se veprimtaritë afariste të cilat realizohen me shfrytëzim të ujit nga trupat ujqorë sipërfaqësor dhe nëntokësor realizohen përmes ndarjes së konsesionit në pajtim me ligjin dhe në par.3 pika 3.2 thuhet se konsesioni ipet për shfrytëzim të fuqisë së ujit për prodhim të energjisë elektrike dhe kjo dispozitë ligjore vlej në rastin konkret të projektit të Kaskadave të Hidrocentraleve të K.. shpk., pasi që Hidrocentralet e sistemit Ranof e përdorin fuqinë e ujit me qellim të prodhimit të energjisë elektrike, po ashtu në këtë nen potencohet qartë që mjetet e realizuara nga ndarja e konsesionit derdhen në buxhetin e Kosovës, e tëra kjo është konstatuar edhe nga e paditura në raport me grupin punues dt. 30.06.2021, e cila është dorëzuar si provë në këtë gjykatë. Është rrezikuar qasje në ujë për banorët e Deçanit si e drejtë themelore e njeriut dhe është vepruar në kundërshtim me nenin 27 dhe 28 të Ligjit 04/L-147 për Ujërat e Kosovës dhe Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut. Me rastin e zbatimit të këtij projekti pra në fazën e ndërtimit janë vendosur kabllo të elektrike mbi rrjetin e shtrirjes së Ujësjellësit të Komunës së Deçanit, duke pamundësuar qasjen për intervenime të ndryshme për sigurim të ujit të pijshëm dhe për përdorim personal nga Kuvendi Komunal Deçan. Nga vizitat në teren sipas raportit të D. të Ujërave të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinorë të dt.16.05.2014, Inspektoratit të Ministrisë së Mjedisit dhe

Planifikimit Hapsinorë që është dorëzuar si provë, është konstatuar se ka humbur një burim i ujit të pijes që furnizon me ujë banoret e Komunë se Deçanit, si dhe janë dhënë konstatimet për dëmet tjera të shkaktuara në drejtim të furnizimit të pa ndërprerë me ujë dhe dëme tjera mjedisore si degradim në zonën e njohur Zalli i Rupës. Sipas këtij raporti KRU ka ngritur shqetësime qysh në fillim të ndërtimeve për rreziqet në raport me rrezikimin e ujërave. Fakti se kompania investuese gjatë punimeve ka vendosur kablo përmbi rrjetin e ujësjellësit paraqet rrezik të vazhdueshëm për furnizim me ujë për banorët e zonës për faktin se ky veprim pamundëson qasjen e kësaj kompanie për intervenime në rrjetin e ujësjellësit. Nuk është mundësuar pjesëmarrja e publikut në lëshimin e lejeve ujore duke vepruar në kundërshtim me ligjin për ujëra dhe Udhëzimin Administrativ për procedura për leje ujore. Lejet ujore janë lëshuar pa u plotësuar kriteret e përcaktuara në Ligjin për ujërat, Udhëzimi Administrativ për procedura për leje ujore dhe rregullores për mënyrën e përcaktimit të prurjes së pranueshme ekologjike. Në raport me lejet mjedisore Organet Shtetërore kanë kryer shkeljet si në vijim: Nuk është përfshirë publiku në vendimmarrje në procedurën e vlerësimit të ndikimit në mjedis duke sjellë kundërligjshmërinë në lejet mjedisore si akt administrativ që derivon nga kjo procedurë, nuk është bërë rehabilitimi i zonës së prekur nga mjedisi si kriter për lëshim të lejes mjedisore duke shkelur kështu ligjin për mbrojtje të mjedisit dhe ligjit për vlerësimin e ndikimit në mjedis. Në raport me licencat e operimit ZRRE ka kryer shkeljet në vijim: I ka mundësuar operatorit të operoi pa leje mjedisore si kushte esenciale si dhe nuk ka garantuar përfshirjen e publikut në vendimmarrje siç përcakton Ligji për Rregullatorin e Energjisë dhe Rregullën për Licencim të Aktiviteteve të Energjisë. Të gjitha këto shkelje tani janë të dëshmuara përmes provave të cilat në vazhdimësi do të administrohen”.

Ndërkaq në fjalën përfundimtare të dorëzuar me shkrim, deklaroi: “Në raport me legjitimitetit aktiv të paditësve- Paditësi F. S., në padinë e ushtruar më datë 4 dhjetor 2020, si dhe në procedurën e pasuar, përkatësisht përmes parashtresës për bashkimin e paditësve M. L. dhe Xh. K., janë mbështetur argumentet që vërtetojnë se të gjithë paditësit kanë cilësinë e palës në këtë procedurë të konfliktit administrativ duke u bazuar në Ligjin nr.03/L -212 për Konfliktet Administrative (LKA), përkatësisht nenin 10, par.1 dhe nenin 21. Gjithashtu, padia në këtë drejtim është mbështetur edhe në nenin 6 par.1 të Ligjit nr.03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, i cili njihet të drejtën palëve të interesuara dhe publikut që të ngre padi apo të kërkojë nga gjykata kompetente të mbrojtje të drejtat e veta në rastet e pësimit të dëmit material apo rrezikut të pësimit të dëmit material që lidhet me çështje mjedisore.

Përveç argumenteve të parashtruara në parashtresën/kërkesën për bashkimin e paditësve, të cilën e ka aprovuar kjo gjykatë, për gjykatën do të shtojmë edhe argumentet si në vijim sa i përket legjitimitetit aktiv të paditësve. Në këtë procedurë të konfliktit administrativ, Gjykata Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Administrative, me aktvendimin e datës 12 mars 2021, ka njohur të drejtën e organizatave jo qeveritare G.. për S.. J.. dhe P.. dhe OJQ P.. që të paraqiten me statusin e ndërhyrës në këtë çështje juridike. Në bazë të nenit 271 të LPK, kushdo mund të ndërhyjë në një proces kontestimor që zhvillohet ndërmjet personave tjetër, kur ka interes juridik për të mbështetur njërin ose tjetrën palë ndërgjyqëse, me të cilën bashkohet në gjykim për ta ndihmuar atë.

Në par.1 dhe 4 të nenit 273, ky ligj ka njohur të drejtën e legjitimitetit procedural të palës ndërhyrëse, përmes ofrimit të mundësisë së ndërmarrjes së veprimeve procedurale. Për ndërmarrjen e veprimeve procedurale nga ana e ndërhyrësit, ekzistojnë vetëm dy kushte kumulative që duhet përmbushur. E para ka të bëjë me faktin se, ndërhyrësi në një procedurë kontestimore mund të parashtrojë propozime dhe të kryejë veprime procedurale tjera brenda afateve në të cilat këto veprime do të mund t'i kryente pala të cilës i është bashkuar. Kurse, kushti i dytë konsiston në faktin se veprimet procedurale të ndërhyrësit, në mënyrë që të kenë efekt juridik, nuk duhet të jenë në kundërshtim me veprimet procedurale të palës për të cilën ka ndërhyrë në procedurë gjyqësore. Me njohjen e statusit të palës ndërhyrëse në këtë procedurë gjyqësore, dhe rrjedhimisht njohjen e legjitimiteti procedural nga ana e LPK, ka shpërfaqur domosdoshmërinë që ato të njoftohen me të gjitha shkresat e lëndës dhe të iu mundësohet kundërshtimi i propozimeve dhe veprimet procedurale të palës kundërshtare. Në pikëpamjen tonë, vlerësojmë se në rrethanat aktuale të rastit konkret është i pashmangshëm korrelacioni i ngushtë në mes të dispozitave ligjore të LKA dhe LPK, në raport me legjitimitetin procedural të palës paditëse, përfshirë edhe ndërhyrësve që marrin pjesë atë në këtë proces gjyqësor.

Neni 10 i LKA, iu njeh të drejtën e palës në procedurë të konfliktit administrativ, rrjedhimisht legjitimitetin aktiv, edhe etniteteve që mbrojnë interesin publik, përfshirë organizatat e shoqërisë civile. Më saktësisht, neni 10, paragrafi 2 LKA decidivisht përcakton se: “Organi i administratës, Avokati i Popullit, shoqatat dhe organizatat e tjera, të cilat veprojnë në mbrojtje të interesave publike mund të fillojnë konfliktin administrativ.” Në mbështetje të kësaj, konsiderojmë se aprovimi i tyre si palë ndërhyrëse në favor të paditësve nënkupton se pala paditëse (që përfshinë edhe organizatat e përmendura) posedojnë legjitimitetin aktiv, si rrjedhojë e interesit juridik për ushtrimin e padisë për inicimin e konfliktit administrativ.

I nderuar gjyqtar Kaçiu, pas argumentimeve në lidhje me legjitimitetin aktiv të palës paditëse, tani do të lëshohemi në elaborimin e kundërligjshmërisë së akteve administrative të kontestuarra në mënyrë kronologjike.

Në raport me lejet ujore, organet shtetërore kanë kryer shkeljet si në vijim: Nuk është respektuar procedura e koncesionimit, i cili është detyrim ligjor që rrjedh nga Ligji Nr. 04/L-147 për Ujërat e Kosovës, përkatësisht neni 78 i tij.

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, i ka dhënë të drejtën e shfrytëzimit të ujit investitorit K.. vetëm me leje ujore, duke anashkaluar detyrimin ligjor për të ndjekur procedurën e koncesionimit. Neni 70 i Ligjit për Ujërat përcakton se fitimi i së drejtës ujore bëhet në dy mënyra: 1) me leje ujore dhe 2) me koncesion. Më tutje, me nenin 72 dhe 78 të Ligjit për Ujërat përcaktohet qartazi se në cilat raste e drejta ujore fitohet me leje ujore dhe se në cilat raste fitohet me koncesion. Në këtë rast konkret duhej të zbatohet neni 78 i Ligjit për Ujërat, në paragrafin 1 thotë se “Veprimtaritë afariste të cilat realizohen me shfrytëzimin e ujit nga trupat ujorë sipërfaqësor dhe nëntokësorë, realizohen përmes ndarjes së koncesionit, në pajtim me ligjin. Ndërsa në paragrafin 3 pika 3.2. thuhet se koncesionimi ipet për shfrytëzimin e fuqisë së ujit për prodhimin e energjisë elektrike. Kjo dispozitë ligjore vlen tërësisht në rastin e projektit të hidrocentraleve të operatorit K.. SH.P.K, pasi që hidrocentralet e sistemit runoff e përdorin fuqinë e ujit me qëllim të prodhimit të energjisë elektrike. E kjo është e mbështetur edhe në provat

që kemi dorëzuar pranë jush: Mendimi i ekspertit të pavarur A. Gj., i datës 20.03.2023, Raporti i Grupit Punues për shqyrtimin e procedurave administrative të zbatuara për hidrocentralet dhe ndikimin e tyre në ujëra dhe mjedisë, datës 30 qershor 2021, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.

Për më tepër, theksojmë se prova e paraqitur nga ana e K.. it në seancën kryesore të datës 11 maj 2023, Vendimi i Këshillit Ndërmnistror për Ujërat i datës 6 dhjetor 2017, nënshkruar nga Kryesuesi i Këshillit Ndërmnistror për Ujëra – Kryeministri i Republikës së Kosovës nuk mund të merret për bazë për arsye se është në kundërshtim me Ligjin. Një ligj mund të ndryshohet vetëm përmes një ligji tjetër. Neni 80 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës përcakton rregullat e miratimit të ligjeve duke vendosur që ligjet, miratohen nga Kuvendi me shumicën e votave të deputetëve të pranishëm dhe që votojnë. Sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës, konkretisht sipas nenit 92, Qeveria zbaton ligjet dhe aktet e tjera të miratuara nga Kuvendi i Kosovës dhe ushtron veprimtari tjera brenda përgjegjësi të përcaktuara me Kushtetutë dhe me ligj. Është parim fundamental i përcaktuar me Kushtetutë që Qeveria merr vendime në pajtim me këtë Kushtetutë dhe me ligje, propozon projektligje dhe amandamentimin e ligjeve ekzistuese e alteve të tjera.

Pra edhe për Kryeministrin si pjesë përbërëse të Qeverisë vlejné këto parime të njëjta. Qeveria mund të propozojë ndryshime të ligjeve ekzistuese, por asnjëherë t'i ndryshojë ligjet përmes vendimeve të Këshillave pa kaluar në procedurat ligjberëse të përcaktuara me legjislacionin në fuqi.

Duhet të përmendim se zbrazëtira ligjore nuk ka ekzistuar në momentin e nxjerrjes së këtij vendimi dhe se Ligji për Ujërat është shumë i qartë. Ashtu siç është shpjeguar në Raportin e Grupit Punues për shqyrtimin e procedurave administrative të zbatuara për hidrocentrale dhe ndikimin e tyre në ujëra dhe mjedis, publikuar më 30 qershor 2021 dallimi në mes të lejes ujore dhe koncesionit qëndron në faktin se koncesioni jepet përmes një procesi konkurrues ndërkaq leja ujore jo. Në këtë raport qartësohet se Ligji për Ujëra përcakton që koncesioni ndahet përmes konkursit publik të organizuar dhe realizuar në pajtim me dispozitat e këtij ligji dhe legjislacionit në fuqi, ndërsa kompensimi dhe ndërprerja e koncesionit rregullohet me Ligjin për Partneritet Publiko Privat. Sidoqoftë, në asnjë rrethanë nuk arsyetohet një vendim i Këshillit, i cili është në kundërshtim me ligjin në fuqi.

Sa i përket deklarimeve të përfaqësuesit të palës së interesit - K.. se Raporti i Grupit Punues për shqyrtimin e procedurave administrative të zbatuara për hidrocentrale dhe ndikimin e tyre në ujëra dhe mjedis, publikuar më 30 qershor 2021 nuk është zyrtar, nuk qëndron fare sepse ky raport është përpiluar nga Grupi Punues i emëruar me Vendim të Ministrit të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës të datës 14 maj 2021, nr. prot 1818/21, i cili është nënshkruar nga Ministri. Ky Raport është publikuar në ueb sajtin zyrtar të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, në linkun: [https://mmphi.rks-gov.net/assets/cms/uploads/files/Raporti%20Final%20i%20Grupit%20Punues%20per%20Hidrocentraletconverted2\(2\).pdf?fbclid=IëAR32ncS_EBa6PmIZG4YLLJCGLTiSFIFkdIFPZ6ëKO_Htz4f2HeEjy1s_xY](https://mmphi.rks-gov.net/assets/cms/uploads/files/Raporti%20Final%20i%20Grupit%20Punues%20per%20Hidrocentraletconverted2(2).pdf?fbclid=IëAR32ncS_EBa6PmIZG4YLLJCGLTiSFIFkdIFPZ6ëKO_Htz4f2HeEjy1s_xY), andaj është i vlefshëm dhe i hartuar nga ekspertët e caktuar nga Ministri i Mjedisit.

Është rrezikuar qasja në ujë për banorët e qytetit të Deçanit si e drejtë themelore e njeriut dhe rrjedhimisht është vepruar në kundërshtim me nenin 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 04/L-147 për Ujërat e Kosovës si dhe Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut (DUDNj).

Me rastin e zbatimit të këtij projekti, përkatësisht në fazën e ndërtimit janë vendosur kabllot elektrike përmbi rrjetin e shtrirjes së ujësjellësit të komunës së Deçanit, duke pamundësuar qasjen për intervenime të ndryshme për sigurimin e ujit të pijshëm dhe për përdorim personal nga ana e qytetarëve të komunës së Deçanit. Nga vizita në terren sipas Raportit të Departamentit të Ujërave të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, i datës 16 maj 2014 i Inspektoriatit të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, i cili është dorëzuar si provë në këtë gjykatë, është konstatuar se ka humbur një burim i ujit të pijes që furnizon me ujë banorët e KK Deçanit, është hedhë shumë material nga gërmimi i kanalit për vendosjen e gypave në pjesën e poshtme të rrugës nga bregu i lumit, është dëmtuar rrethoja e kaptazhës kryesore prej nga fillon furnizimi me ujë, që është arteria kryesore e furnizimit. Mbi kanal të gypit është hedhur sasi e madhe e materialit nga gërmimi i kanalit për dislokimin e një gypi, është ngushtuar shtrati i lumit nga materiali i hedhur në bregun e tij, si dhe është bërë degradimi jashtëzakonisht i madh në ambient nga eksploatimin e zhavorrit dhe rërës në vendin e ashtuquajtur “ZALLI I RUPËS” – pa asnjë dokument nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, KK Deçan dhe pa asnjë kriter.

Po ashtu, sipas këtij raporti, kompania rajonale e ujësjellësit, KUR “HidroDrini” Sh.A-Pejë, ka ngritur shqetësimet qysh në fillim të ndërtimeve për rreziqet në raport me rrezikimin e burimeve ujore. Me anë të shkresës së dorëzuar në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë, Njësinë për Monitorimin Ndërmarrje Publike Kuvendin Komunal – Deçan dhe Investitorin (kontraktorin).

Në këtë shkresë potencohet se brenga kryesore është mbrojtja e burimeve që janë jetike për popullatën e rajonit të Deçanit, si dhe respektimin e zonave të mbrojtura. Në anën tjetër, fakti se kompania investuese, gjatë punimeve ka vendosur kabllot elektrike përmbi rrjetin e ujësjellësit, paraqet rrezik të vazhdueshëm për furnizim me ujë për banorët e zonës, për faktin se ky veprim arbitrar pamundëson qasjen e kësaj kompanie për intervenime në rrjetin e ujësjellësit. Për më tepër, kjo kompani rajonale kishte informata nga institucionet e nivelit qendror, se si dhe në çfarë mënyre do të ndikojë ky projekt në burimet jetike të ujit të pijshëm, duke marrë për bazë se burimet gjenden në pjesën ku në periudhën përkatëse ishin duke u zhvilluar punimet për implementimin e projekteve të hidrocentraleve.

Mirëpo, këto fakte të paraqitura nga ana e kompanisë KUR “HidroDrini”, asnjëherë nuk janë marrë parasysh, duke përfshirë edhe në procedurën e lëshimit të lejes ujore. Një veprim i tillë, duke rrezikuar burimet ujore është në kundërshtim të plotë me nenin 27 dhe 28 të Ligjit për Ujërat. Këto nene në mënyrë shumë të qartë përcaktojnë hierarkinë e shfrytëzimit të ujërave, duke vendosur nevojat e konsumit, bujqësisë dhe përgatitjes së ushqimit si primare me rastin e vendosjes së organeve shtetërore për lëshimin e lejes ujore për një qëllim të caktuar.

Sa i përket të drejtës për qasje në ujë dhe rëndësisë së saj, për gjykatën, dëshirojmë të vendosim në pah edhe Deklaraten Universale të Drejtave të Njeriut (DUDNj, 1948) dhe Paktin Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore (PNDESK, 1966). Ndonëse këto instrumente ndërkombëtare nuk e përmendin ujin në mënyrë eksplicite, megjithatë një e drejtë ndërkombëtare e njeriut për ujë ka dalë në mënyrë progresive nga interpretimi i këtyre instrumenteve në lidhje me të drejtën e njeriut për një standard të përshtatshëm jetese. DUDNj parashikon se: “Secili ka të drejtë për një standard jetese të përshtatshëm për shëndetin dhe mirëqenien e tij dhe të familjes së tij, duke përfshirë ushqimin, veshmbathjen, strehimin dhe kujdesin mjekësor dhe shërbimet e nevojshme sociale... (Neni 25.1).”

Në anën tjetër, neni 11 par.1 i PNDESK, qartazi parashikon se: “Shtetet Palë të këtij Pakti njohin të drejtën e secilit për një standard të përshtatshëm jetese për veten dhe familjen e tij, duke përfshirë ushqimin, veshjen dhe strehimin e duhur, dhe për përmirësimin e vazhdueshëm të kushteve jetesës”, është me rëndësi të veçantë të përmendet komenti gjeneral nr.15 i Komisioni për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, i titulluar The Right to Water (GC 15, CESCR, 2002a, viti 2003).

Ky koment sqaron detajisht se e drejta në ujë nuk është statike dhe fokusohet në qëndrueshmëri, pra zbatimi duhet jo vetëm të përmbushë nevojat e tanishme por edhe ato të ardhshme. Madje, ky koment i Komisionit bën një ndërlidhje jetike mes të drejtës në ujë dhe asaj për ushqim dhe mjedis të shëndoshë. Duke vendosur në dritë rrethanat se si janë lëshuar lejet ujore si akte administrative të kundërligjshme, pa hezitim mund të konstatohet se kemi shkelje direkte edhe te DUDNj, dispozitat e së cilës gjejnë zbatim të drejtpërdrejtë, ashtu siç është përcaktuar në nenin 22 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Sa i përket pretendimeve të palës së interesit - K.. Sh.p.k, se raporti që është bashkëngjitur si provë është i hartuar para 9 viteve dhe se nuk ka të bëjë me aktet administrative të kontestuara, paditësit dhe pala ndërhyrëse vlerësojnë se ato janë të paqëndrueshme për arsyen si në vijim. Fakti se Raporti i Departamentit të Ujërave të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, i datës 16 maj 2014, Inspektim në bazë të ankesës së Hidrodrinit rreth ndërtimin e HEC-ve, Deçan, konstaton mungesë të burimit të ujit të pijes dhe ndërhyrjen arbitrare në vendosjen e kabllave përmbi gypat e ujësjellësit, është provë e pakontestueshme që vërteton shkaktimin e rrezikut për furnizim për ujë të pijshëm dhe rrjedhimisht detyrimin që palës së interesit - K.. Sh.p.k të mos i lëshohet leja ujore. Për më tepër, ky argumentim përforcohet edhe më shumë kur kemi parasysh se këto dëme të shkaktuar në rrjetin e ujësjellësit asnjëherë nuk janë evituar, ashtu siç vërtetohet nga komunikimi elektronik në mes të përfaqësues së organizatës jo-qeveritare Pishtarët dhe Kryeshefit Ekzekutiv të KUR “Hidrodrini” Sh.A - Pejë, i datës 27.03.2023, ku ky i fundit konstaton se nuk ka pasur asnjë përmisim të gjendjes në drejtim të rregullimit të mbledhësve të ujit dhe të zhvendosjes së kabllave elektrike që i kanë vendosë mbi gypat e ujësjellësit në Grykën e Deçanit.

1. Nuk është mundësuar pjesëmarrja e publikut në procedurën e lëshimit të lejeve ujore, duke vepruar kështu në kundërshtim me Ligjin për Ujërat dhe Udhëzimin Administrativ për Procedurat për Leje ujore

Përveç shkeljeve të sipërcituara, e të cilat për ne si paditës konsiderohen si bazë e mjaftueshme për anulimin e lejeve ujore për këto tri hidrocentrale, Ministria e Mjedisit edhe në procedurën e lëshimit të tyre ka shkelur të drejtat kushtetuese të qytetarëve të Republikës së Kosovës për pjesëmarrje në çështje mjedisore. Kjo për faktin se procedurat e përcjellura, nuk kanë respektuar nenin 84, paragrafi 10 të Ligjit për Ujërat nenin 25 të Udhëzimit Administrativ Nr. 03/2018 për Procedurat për Leje Ujore dhe nenin 57 të Ligjit Nr.03/L-025 për mbrojtjen e mjedisit, të cilat garantojnë të drejtën kushtetuese për pjesëmarrje në vendimmarrje për çështjet që prekin mjedisin të paraparë në nenin 52 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës – në këtë rast ujërat. Këto diskutime publike nuk kanë ndodhur asnjëherë dhe Komuna e Deçanit dhe Ministria përkatëse nuk e kanë siguruar pjesëmarrjen dhe rolin aktiv të publikut gjatë marrjes së vendimeve për, ndër të tjera, procedurën e lëshimit të lejeve ujore. Kjo vërtetohet edhe nga fakti se në arsyetimin e lejeve ujore të lëshuara e të kontestuara me padinë tonë, në asnjë pikë nuk përmendet procedura e konsultimit publik në mënyrë kronologjike, duke përkrahur qartë se kur është bërë publikimi i aplikimit, kush ka dhënë komente dhe sygjerime dhe se si janë trajtuar ato nga ana e Ministrisë.

Lejet ujore janë lëshuar pa u plotësuar kriteret e përcaktuara në Ligjin për Ujërat, Udhëzimit Administrativ për Procedurat për Leje Ujore dhe Rregullores për mënyrën e përcaktimit të prurjes së pranueshme ekologjike;

Edhe po të ndjeknim rrugën e Lejeve Ujore për hidrocentrale, me lëshimin e lejeve ujore të kontestuara, Ministria e Mjedisit kryen shkelje ligjore materiale të ligjeve të përmendura më lartë duke konkluduar se: “Studimi i PPE-së – Prurjes së Pranueshme ekologjike duhet të hartohet në përputhje me kërkesat e rregullores së MMPH-së, me nr.02/2016”. Për mënyrën e përcaktimit të prurjes së pranueshme ekologjike”, në afat prej 60 ditësh. Ky detyrim i përcaktuar me leje ujore si akt ujqor është në kundërshtim me nenin 8 të Udhëzimit Administrativ nr.03/2018 për Procedurat për Leje Ujore dhe nenin 18 të Rregullores 02/16 për mënyrën e përcaktimit të prurjes së pranueshme ekologjike.

Neni 8 i Udhëzimit Administrativ Udhëzimit Administrativ nr.03/2018 për Procedurat për Leje Ujore përcakton përmbajtjen e kushteve ujore, ku ndër të tjera në par.3 pika 3.2.përmendet studimi i prurjes së pranueshme ekologjike si një nga dokumentet tekniko-investigativ që duhet të finalizohet, në mënyrë që pastaj të vazhdohet me lëshimin e akteve tjera ujore siç është pëlqimi ujqor dhe leja ujore si akt përfundimtar që mundëson shfrytëzimin e ujit për qëllimin e përcaktuar sipas Ligjit për Ujërat.

Mirëpo në rastin konkret, në lejet ujore të kontestuara, është vënë si obligim kryerja e PPE-së 60 ditë pas lëshimit të saj, e jo në fazën e lëshimit të kushteve ujore dhe si kriter për lëshimin e pëlqimit ujqor siç e përcakton udhëzimi administrativ që derivon nga Ligji për Ujërat. Një veprim i tillë është në kundërshtim edhe me nenin 18 të Rregullores 02/16 për mënyrën e përcaktimit të prurjes së pranueshme ekologjike, i cili në paragrafin e parë qarte thotë se raporti për përcaktimin e prurjes së pranueshme ekologjike në profilin e një veprë ujëmarrese, duhet të jetë pjesë e dokumentacionit të nevojshëm për lëshimin e pëlqimit ujqor. Në këtë rast e paditura dha pala e interesuar, nuk kanë hartuar programin e monitorimit të prurjes së pranueshme

ekologjike, bazuar në paragrafin 2 dhe 3 të nenit 18 të Rregullores 02/16 për mënyrën e përcaktimit të prurjes së pranueshme ekologjike. Për më tepër, Ministria nuk kë dhënë asnjë afat kohor për instalimin e matësve të ujit që do të vinte pas bërjes së studimit, që nënkupon se Ministria nuk kishte zbatuar asnjë mekanizëm që siguron se operatori është duke zbatuar rregulloren nr.3/2018 dhe që në lum do të mbetej sasi e mjaftueshme e ujit që i nevojitet jetesës në lum. Kështu, një procedim i tillë i Ministrisë, duke lëshuar leje ujore, pa u siguruar se operatori ka kryer studim të mirëfillte të prurjes së pranueshme ekologjike, paraqet shkelje të qartë ligjore të Ligjit për Ujërat, Udhëzimit Administrativ nr.03/2018 për Procedurat për Leje Ujore dhe Rregullores 02/16 për mënyrën e përcaktimit të prurjes së pranueshme ekologjike, duke ia mundur palës së interesit operimin pa i plotësuar kushtet ligjore.

Në raport me lejet mjedisore, organet shtetërore kanë kryer shkeljet si në vijim:

Nuk është përfshirë publiku në vendimmarrje në procedurën e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, duke sjellë kundërligjshmëri në lejet mjedisore si akt administrativ që derivon nga kjo procedurë;

E nderuar gjykatë, pikë së pari dëshirojmë të ju informojmë për faktin se njoftimi publik për mbajtjen e debatit publik për raportin e vlerësimit të ndikimit në mjedis për këtë projekt siç e parasheh neni 20 i Ligji Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis është bërë i ditur për paditësit dhe ndërhyrësit në fazat e mëvonshme të procesit, duke shpërfaqur mungesën totale të transparencës në këtë rast.

Për më tepër, në bazë të rrjedhës së procedurës së mbajtjes së debatit publik, qartazi vërehet se nuk ka pasur përfshirje të qytetarëve në vendimmarrje për këtë projekt. Kjo vërehet nga fakti se në këtë rast nuk janë respektuar dispozitat ligjore të Ligjit Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, pasi që nuk janë respektuar paragrafët 1 dhe 4 të nenit 22 të Ligjit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis. Të paditurat janë vetëmjaftuar vetëm me publikimin e njoftimit në gazetën e përditshme e cila është bërë nga operatori K.. Sh.p.k. (pala me interes), mirëpo nuk ka asnjë dëshmi që sipas këtij njoftimi, i cili ka përcaktuar shqyrtimin publik në vendin e caktuar dhe me datë të caktuar, që është mbajtur dhe sipas një procesverbali është konstatuar pjesëmarrja apo mospjesëmarrja e publikut dhe e Ministrisë në këtë ditë.

Rezultatet e konsultimeve dhe informatat e mbledhura në pajtim me dispozitat e këtij ligji, nuk janë marë në shqyrtim gjatë marrjes së vendimit për Pëlqim Mjedisor, dhe se pas marrjes së vendimit për lejimin ose refuzimin e Pëlqimit Mjedisor, Ministria nuk ka informuar publikun me vendimin, përmes një njoftimi lokal për ndër të tjerat, edhe për arsyet kryesore dhe elementet mbi të cilat është bazuar vendimi përfshirë edhe nëse është relevante, informatat lidhur me pjesëmarrjen e publikut.

Gjithashtu, Ligji për Procedurën Administrative gjen zbatim për nxjerrjen e akteve administrative të këtij rasti, përfshirë edhe pëlqimin mjedisor. Në rastin e nxjerrjes së vendimit për pëlqim mjedisor për këtë rast, nuk janë respektuar dispozitat ligjore të nenit 85 të Ligjit Nr. 02/L-28 për procedurën administrative, që ka qenë në fuqi në kohën e nxjerrjes së këtij akti administrativ, e që përcakton elementet e arsytimit të një akti administrativ.

Duke qenë se sipas Ligjit nr.03/L-025 për mbrojtjen e mjedisit, neni 31, lëshimi në punë i objektit të ndërtuar apo i stabilimenteve dhe pajisjeve që kanë qenë objekt i vlerësimit të ndikimit në mjedis, nuk mund të fillojë veprimtarinë pa marrjen e lejes mjedisore, konstatohet një lidhje e patejkalueshme në mes pëlqimit mjedisor dhe lejes mjedisore. Një rrjedhe e tillë e procedurës e ndjekur nga ana e Ministrisë përkatëse dhe operatorit K.. në raport me debatin publik për raportin e vlerësimit të ndikimit në mjedis, konstaton kundërligjshmërinë e lejeve mjedisore të atakuara me padinë tonë, ndër të tjera, edhe si derivat i parregullsisë së procedurës së mbajtjes së debatit publik për raportin e vlerësimit të ndikimit në mjedis.

Nuk është bërë rehabilitimi i zonës se prekur nga mjedisi si kriter për lëshimin e lejes mjedisore, duke shkelur kështu Ligjin për Mbrojtjen e Mjedisit dhe Ligjin për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis.

Kriteret për lëshimin e lejes mjedisore janë shumë rigorozë dhe kanë për qëllim mbrojtjen e ujit dhe mjedisit nga dëmet potenciale gjatë ndërtimit. Ligji Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit në kreun IV ka paraparë lejen mjedisore si një nga kushtet dhe masat kryesore për mbrojtjen e mjedisit. Sa i përket projektit të kaskadës së hidrocentraleve në lumbardh të Deçanit, informojmë gjykatën se prej fazës së ndërtimit në 2013 dhe më pas, operatori i ka shkaktuar dëme të skajshme lumit dhe ambientit për rreth, të cilat madje në shumë vende janë të pa riparueshme. Dokumentim i dëmeve është bërë edhe nga kompania rajonale Hidrodrini, ku i përmendëm më lartë, komuna e Deçanit, Inspektorati i MMPHsë, si dhe fotografitë e dërguara si provë pranë kësaj gjykate, ku qartazi vërtetohet së asnjehere nuk është bërë rehabilitimi i zonës ku janë zbatuar këto projekte.

Kompania K.. , në përgjigjen në padi, përkatësisht provën 2 ka ofruar disa fotografi që gjoja dëshmojnë investimet e tyre dhe rehabilitimin që e kanë bërë në dhe për rreth aseteve të ujësjellësit të Deçanit. Duhet sjellë vëmendja e gjykatës pikërisht në këto foto sepse aty ku K.. e paraqet si investim në komunitet, dhe se si kinse e kanë revitalizuar ambientin dhe ndërtuar park, është pikërisht taktikë e tyre për të mbuluar një ndër dëmet më të mëdha që kanë shkaktuar. Siç shihet në fotot e dorëzuara nga para ndërtimit të HC-ve nga ana e Raportit të Departamentit të Ujërave të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, i datës 16 maj 2014, i Inspektimit në bazë të ankesës së Hidrodrinit rreth ndërtimit të HC-ve, Deçan, niveli i rrugës dhe ai i lumit rreth aseteve të Hidrodrinit ishte i njëjtë.

Pra, edhe ujësjellësi ishte në nivel me lumin dhe rrugën dhe komuniteti gjithmonë kishte qasje në lum. Gjatë punimeve për shtrirjen e gypave të HC-ve, kompania K.. , pa e njoftuar Hidrodrinin ka gërmuar nëpër linjen ku ndodhej gypi i ujësjellësit dhe siç është dëshmuar më lartë nga Hidrodrini, ka dëmtuar gypin ekzistues të ujësjellësit dhe në atë kohë banorët e fshatrave të ndryshëm në Deçan kanë mbetur pa ujë për disa ditë. Edhe pas ndërhyrjes së Hidrodrinit, K.. i ka shtrirë gypat e tyre përgjatë lumit, ku ka bërë ngritje drastike të nivelit të tokës për rreth ujësjellësit, kështu e kanë bërë të pamundur qasjen në lum, e kanë varrosur disa metra më thellë gypin e ujësjellësit, që e bën tejet të vështirë qasjen në të, në rast të nevojës për intervenim, dhe gjithashtu e kanë lënë ujësjellësin në gropë, ku çdo ditë rrezikohet uji i pijshëm nga shirat dhe mbeturinat që derdhen aty. Pra, të gjitha këto dëme kompania K.. i mbulojë me një sipërfaqe që tashmë e quan "park" për qytetaret e Deçanit.

Gjithashtu, vlen të përmenden dëmet në zonën e Zallit të Rupës, ku ndër të tjera janë tharë disa kilometra të deges së lumbardhit- Përroi Shqiptarë, janë dëmtuar urat dhe rruga që përdoret nga komuniteti nga shembja e dheut dhe bartja ilegale e zallit, që dokumentohen nga fotot e dorëzuara. Nuk është ndërtuar bazeni akumulues, ashtu siç ishte e paraparë në projekt dhe kontratën me komunë të Deçanit, dhe ishte kusht për lëshim të Lejeve Mjedisore, nuk është bërë legalizimi i trasesë së gypave në mënyrë ligjore, gjë që është identifikuar edhe në raportin e Grupit Punues, dhe ishte kusht për lëshim të Lejeve Mjedisore.

Duhet theksohet fakti se kompania K.. nuk i ka përmbushë asnjë nga tjerat detyrime në kontratën me komunë të Deçanit, që përfshijnë edhe rehabilitimin e zonës së prekur.

MMPH me lëshimin e akteve administrative të kontestuara, pa u siguruar që të gjitha dëmet dhe problemet që kanë lind nga ndërtimi i këtyre hidrocentraleve janë revitalizuar dhe adresuar në mënyrën më të mirë të mundshme, i bën lejet mjedisore të lëshuara me shkelje ligjore të nenit 9 par.1 pika 1.9 të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit, i cili saktësisht potencon se: “Mbrojtjen e resurseve natyrore e sigurojnë institucionet e Kosovës në përputhje me ligjet e kësaj fushe si dhe përmes: 1.9. rehabilitimit dhe rikthimit të mjedisit në gjendjen e mëparshme në përputhje me projektin”. Gjithashtu, lejeve mjedisore si akte administrative i mungojnë të gjitha elementet, përkatësisht arsyetimi, ashtu siç përcaktohet me nenin 47 dhe 48 të Ligjit Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Në raport me licencat e operimit, Zyra e Rregullatorit të Energjisë ka kryer shkeljet në vijim:

Zyra e Rregullatorit të Energjisë i ka mundësuar operatorit që të operojë pa pajisur me leje mjedisore si kusht esencial, si dhe nuk ka garantuar përfshirjen e publikut në vendimmarrje, ashtu siç përcakton me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë dhe Rregullës për licencim të aktiviteteve të energjisë;

E nderuar gjykatë, ZRRE si e paditura e dytë, në procesin e lëshimit të licencës afatgjatë për investitorin, ka shkelur dispozitat ligjore të akteve ligjore të sipercituara, për arsye se ka dështuar që të bëjë njoftimin publik për aplikim, dhe se provat e dorëzuara nga ana jonë qartazi vërtetojnë këtë fakt. Neni 6 i Rregullës për licencim të aktiviteteve të energjisë në Kosovë, përcakton se publikimi i njoftimit publik bëhet pasi që konstatohet se dokumentacioni i aplikuesit është i kompletuar, pra që përfshinë edhe pajisjen me leje mjedisore si kusht esencial për plotësimin e kriterëve për mbrojtjen e mjedisit, e që në rastin e palës së interesit K.. kjo nuk ka ndodhur pasi që leja mjedisore dhe licenca e lëshuar nga ZRRE janë publikuar në të njëjtën ditë, pra me 12.11.2020.

Për më tepër, elaborimi i të të paditurës së dytë ZRRE në seancën përgatitore të mbajtur me 19.04.2023 se pala e interesit K.. ka bërë njoftimin për aplikim për licencim pa qenë e pajisur me leje mjedisore por vetëm me certifikatë të përdorimit, vërteton shkeljet e dispozitave procedurale të Ligjit Nr.05/L-084 për Rregullatorin e Energjisë, Ligjin për Mbrojtjen e Mjedisit dhe akteve nënligjore që rrjedhin nga to. Neni 30 i Ligjit Nr.05/L-084 për Rregullatorin e Energjisë, par.2 pika 2.3 potencon se kriteret për dhënien e licencës do të ndërliken, deri në masën përkatëse të kërkesave të licencës së tillë me mbrojtjen e mjedisit. Kriteret për mbrojtjen

e mjedisit janë paraparë në Ligjin për Mbrojtjen e Mjedisit, i cili ka paraparë lejen mjedisore si masë për mbrojtjen e mjedisit.

Në anën tjetër, Udhëzimi Administrativ nr.07/17 për Leje Mjedisore, që ka qenë në fuqi në kohën e nxjerrjes së licencave nga ZRRE, në nenin 5 potencon se varësisht nga veprimtaria, operatori duhet ta dorëzoj edhe certifikatën e përdorimit, në mënyrë që te pajisjet me leje mjedisore. Pra, kjo nënkupton se fillimisht operatori duhet të pajisjet me certifikatë të përdorimit pastaj me leje mjedisore si akt përfundimtar që mundëson lëshimin në punë të aktivitetit në bazë të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit.

Po ashtu, dokumentet e dorëzuara nga ZRRE me të cilat pretendohet të vërtetohet fakti se ka pasur publikim të njoftimit për aplikim nga ana e investitorit K.. Sh.p.k dhe se është mbajtur debat publik në muajin shtator të vitit 2019 apo 2018, kanë defekte esnciale dhe janë prova të pambështetshme për gjykatën për dy arsye.

Së pari, përmbajtja e provës mbetet e panjohur për gjykatën dhe paditësit, pasi që është e pamundur të evidentohet se çka përmban ajo, duke përfshirë shpjegimin e publikimit dhe datat kur është publikuar njoftimi ashtu siç elaboron e paditura e dytë, ZRRE.

Së dyti, edhe në një rrethanë ku kjo provë do të ishte qartësisht e lexueshme dhe e kuptueshme, në vështrimin e paditësve, ajo veçse konfirmon argumentimin tonë se e paditura e dytë ka kryer shkelje ligjore, duke filluar procedurën e publikimit të aplikimit dhe konsultimit publik, pa u siguruar se investitori K.. Sh.p.k ka përmbushur të gjitha kërkesat mjedisore bazuar në ligjet relevante.

Në anën tjetër, nga ana e paditësve është vërejtur se ZRRE si e paditur vazhdimisht është thirrur në faktin se ajo vetëm ka proceduar administrativisht me aplikacionin e investitorit për licencë afatgjatë, duke reduktuar rolin e saj në një lloj sekretarie për organet tjera të MMPHI-së. Një interpretim i tillë është i gabuar dhe ka për tendencë shmangien nga obligimet që ka ZRRE në bazë të Ligjit Nr. 05/L-084 për Rregullatorin e Energjisë, i cili i jep këtij institucione kompetencë ekskluzive për lëshimin e licencave të operimit. Më saktësisht, neni 28 par.1 i këtij ligji thotë se: “Aktivitetet e energjisë, kryhen nga ndërmarrjet për energji në bazë të licencave të lëshuara nga Rregullatori.”. Pra, kjo dispozitë përcakton se asnjë aktivitet i energjisë nuk mund të zhvillohet pa licencë të lëshuar nga ZRRE dhe se ajo duhet të sigurohet se aktiviteti i tillë përmbush kriteret paraprake, duke përfshirë edhe ato mjedisore nëse janë relevante.

Në mishërrimin tonë për ta mbrojtur pasurinë e përbashkët të shtetit tonë, gjatë hulumtimeve të fundit, i nderuari gjyqtar, kemi gjetur edhe kërkesën e cila ju është adresuar KOMITETIT PËR ENERGI (në kuadër të BE) i cili është angazhuar për negociimin e mosmarrëveshjes në mes të paditurave dhe palës së interesit K.. SH.P.K, kjo le për të kuptuar që këto akte ligjore të dhëna dhe i tërë ky proces i investimit ka kaluar me, shkelje ligjore gjë që ka lejuar dëme të pariparueshme mjedisore dhe e cila është pasuri e jona e përbashkët që i është dhënë një investitori privat nga i cili buxheti shtetëror i yni nuk përfiton asgjë. Më poshtë gjeni linkun që dëshmon pranimin e kësaj kërkesë nga Komiteti për Energi, me datën 22 dhjetor 2022:

**<https://ëë.energy-community.org/neës/Energy-Community-Neës/2022/12/20a.html>*

Gjithashtu, dëshirojmë të theksojmë të gjitha shkeljet e gjetura në raportin e Grupit Punues dhe rekomandimet që ky grup i ka bërë MMPH se për të adresuar shkeljet.

I nderuar gjyqtar, pas të gjitha provave të administruara, të cilat dëshmojnë dhe mbështesin kërkesëpadinë dhe padinë tonë, ne jemi të bindur në paligjshmërinë e këtyre akteve ligjore të marra nga të paditurat, andaj kërkojmë që gjykata të nxjerrë këtë Aktgjykim me të cilin APROVOHET në tërësi padia e paditësve F. S., M. L. dhe Xh. K., si dhe ndërhyrësëve OJQ “P..” dhe G.. për S.. J.. dhe P.. kundër Ministrisë të Ekonomisë dhe Ambientit të Republikës së Kosovës dhe Zyrës së Rregullatorit për Energji, Anulohen Leja ujore [HC Bellaja], MEA L.U. 13, 3.11.2020; Leja ujore [HC Deçani], MEA L.U. 14, 4.11.2020; Leja mjedisore [HC Bellaja], MEA 19/5837/ZSP, 6.11.2020; Leja mjedisore [HC Deçani], MEA 19/5837/ZSP, 6.11.2020; Vendim [HC Deçani], ZRrE V_1303_2020, 12.11.2020; Vendim [HC Bellaja], ZRrE V_1304_2020, 12.11.2020; Licencë [HC Deçani], ZRrE/Li_49/20, 12.11.2020; Licencë [HC Bellaja], ZRrE/Li_50/20, 12.11.2020; Vendimi për leje ujore për HC Lumbardhi II, L.U., nr. prot. 5058/20, lëshuar nga e paditura MEA më 3 shkurt 2021”.

E paditura e parë Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit, me përgjigjen në padi të datës 24.06.2022 e konteston në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë si të pabazuar duke pohuar se vendimi i atakuar është marrë konform të gjitha dispozitave në fuqi dhe ajo në të cilën pretendon pala se ky vendim është marrë me shkelje ligjore nuk qëndron fare. Për arsye se vendimi i atakuar është marrë konform legjislacionit në fuqi dhe në mënyrë të drejtë, ashtu që pretendimet e veta pala paditëse nuk i ka vërtetuar as edhe me një provë, andaj e paditura i propozon Gjykatës që të marr Aktgjykim me të cilin refuzohet në tërësi si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit dhe mbetet në fuqi vendimi i të paditurës.

Në seancën e shqyrtimit kryesor, përfaqësuesja e të paditurës së parë, deklaroi: “E kundërshtoj në tërësi padinë e paditësve. Mbetem pranë përgjigjes në padi dhe sqarimit të dhënë në të, po ashtu deklaroi se vendimi mbi dhënien e lejes ujore është bërë në bazë të ligjit për mbrojtje të mjedisit, ligjit për verifikim të ndikimit në mjedis, ligjit të ujërave, udhëzimeve sipas Asociacionit Evropian të hidrocentraleve si dhe në bazë të ligjit për planifikim hapësinor, pra vendimi i atakuar është marrë në bazë të këtyre normave ndërsa sa i përket deklarimeve dhe provave të paraqitura nga e autorizuar e paditësve do të deklarohemi me shkrim në fjalën përfundimtare duke dhënë sqarim për secilën”.

Ndërkaq në fjalën përfundimtare të dorëzuar me shkrim dhe në formë elektronike, deklaroi: “E autorizuar e të paditurës deklaroi se mbetemi pranë gjitha deklarimeve në seancat e mbajtura në këtë gjykatë si dhe përgjigjes në padi, duke shtuar se Fillimisht e kundërshtojmë në tërësi padinë e paditëses si të pa bazuar. Në përmbajtjen e padisë së paditëses të cilët kanë kërkuar anulimin e vendimit të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinorë dhe Infrastrukturës vërehet qartë një mos precizim i i saktë i kontestimit në kuptim të anulimit të aktit administrativ duke parashtruar pyetje në formë hipotezash të paarsyeshme dhe të pa argumentueshme në fakte. Tutje, pas këtyre pyetjeve të ngritura në bazë të hipotezave tentohet në mënyrë të pastër subjektive që të kontestohet ndërtimi i përmbajtjes së aktit administrativ pa ndonjë mbështetje

juridike. Në këtë aspekt, konsiderojmë se padia për anulimin e aktit administrativ është në përputhje me Kushtetutën e Kosovës dhe aktet ligjore të përcaktuar në përmbajtjen e këtij vendimi. Krejt kjo për faktin se mënyra e nxerrjes së këtij akti nga e paditura është bërë duke pasë parasysh të gjitha rekomandimet e ekspertve të lëmisë përkatëse dhe atë në pajtueshmëri me Ligjin për ujrat, Ligjin për Ambientin, dhe atë me kujdesin maksimal për të mos pasur pasoja në ambient.

Pretendimi i të autorizuarës së paditësit lidhur me pasojat gjoja të shkaktuara e cila pa të drejtë flet në emër edhe të institucioneve të Deçanit si komunës dhe ujësjellësit e po ashtu edhe në emër të banorëve të atjeshëm, nuk qëndrojnë fare se po të ekzistonte një dëm i tillë do ta ngrisinin si qështje komplet banorët e atjeshëm. Prandaj pretendime të tilla tregojnë përmbajtjen e hiptozave të gabueshme nga ana e palës paditëse. Pala paditëse, për fund përmend edhe sigurinë shendetësore, me pretendimin se “veprimet e veta Ministrisa e Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinorë dhe Infrastrukturës duke lëshuar vendimin për leje ujore ka rrezikuar shëndetin dhe ka shkaktuar mungesën e ujit të ujin e pishëm është i pabazë, i paarsyeshëm dhe në kundërshtim me logjiken juridike. Nuk mund të themi që është vepruar pa ligjshem dhe në dëm të banorëve kur i gjithë procesi i organizimit dhe funksionimit deri te marrja e vendimit është bërë në pajtim me ligjet e cekura më lartë, duke u bazuar edhe në konventat për hidrocentralet dhe në konsulltim të vazhdueshem me ekspert të lëmisë përkatëse. Vendimi i atakuar është marrë konform Ligjit për Procedurën Administrative Ligjit për Ujrat, ligjit për Ambientin si dhe Konventës për hidrocentrale, duke parë një për një kriteret e përcaktuara me këtë konventë, andaj duke u bazuar në këtë ,Gjykatës i propozojmë që të merr Aktgjykim me të cilin refuzohet në tërësi Padia dhe kërkesëpadia e paditësit, si e pa bazuar në Ligj dhe mbetet në fuqi Vendimi i MMPHI-së”.

E paditura e dytë, Zyra e Rregullatorit për Energji, me përgjigjjen në padi të datës 11.03.2022, e ka kontestuar në tërësinë padinë dhe kërkesëpadinë e paditësve si të pabazuar duke pohuar se vendimet për lëshimin e Licensave për prodhimin e energjisë elektrike nga burimet e ripërtëritshme gjegjësisht hidrocentraleve, janë lëshuar në pajtim me obligimet ligjore që janë zbatuar nga ZRRE-ja, sa i përket aspektit administrativ të shqyrtimit dhe bazuar në vendimet për lëshimin e Lejeve Mjedisore të lëshuara nga Ministria e Ambientit dhe të sjellura nga ana e subjektit juridik K.. Energy Sh.P.K. Shton se kohëzgjatja e dhënies së licensës është bazuar në nenin 32 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, prandaj nuk janë të sakta pretendimet që nuk është respektuar parimi i ligjshmërisë. ZRRE me të drejtë konsideron se ka zbatuar me përpikëri legjislacionin në fuqi duke marrë parasysh edhe faktin se ka shërbyer si sekretariat te e cila janë drejtuar investitorët mbi mënyrën e investimit të kapaciteteve të reja gjeneruese për energji të ripërtëritshme. Shton se gjykata e shkallës së parë duhet të marrë parasysh edhe obligimet ligjore të Ligjit Nr.04/L-220 për Investimet e Huaja ku me nenin 3, paragrafi 2 të këtij ligji, definohet se: “Republika e Kosovës i siguron investitorët e huaj dhe investimet e tyre mbrojtje dhe siguuri të plotë dhe të vazhdueshme në përputhje me legjislacionin në fuqi”. Prandaj i propozon Gjykatës që pas shqyrtimit kryesor dhe provave të administruara, të marr Aktgjykim me të cilin refuzohet padia e paditësve si e pabazuar si dhe të refuzohet kërkesa e paditësve për kompensimin e shpenzimeve të përfaqësimit.

Në seancën e shqyrtimit kryesor, përfaqësuesi i të paditurës së dytë, deklaroi: *“ZRRE e konteston në tërësi padinë paditësit si dhe pretendimet e saja të paraqitura me padi gjithashtu edhe të palës ndërhyrëse. Po ashtu mbetemi në tërësi pranë deklarimeve të dhëna në seancën e kaluar duke kundërshtuar secilën pikë dhe pretendim të paditësve. Ne deklarojmë se vendimet për lëshim të licencave për operim për HC Belaja dhe HC Deçan, janë të mbështetura në dispozita ligjore të nenit 9, 15,26, 28 dhe 38 të Ligjit për Rregullatorin për Energji, dispozitat e nenit 6 të Ligjit për Energji Elektrike, dispozitat e rregullës për licencim të aktiviteteve për Energji në Kosovë, dëshmitë dhe provat e siguruara nga K.. dhe Institucionet e Kosovës përfshirë lejet ujore, mjedisore si fazë e fundit para licencimit të cilat kanë mbështetje të plotë për vendimet e lëshimit mjedisor të vitit 2010, të dëshmuara edhe nga raporti i ndikimit në mjedis si dhe lejet ujore të lëshuara në atë kohë dhe po ashtu edhe në publikimet e njoftimeve sipas rregullit për licencim brenda afatit kohorë kur palët kanë pasur të drejtë ligjore për të paraqitur kundërshtimet e tyre lidhur me licencat. Theksojmë se vendimet për licenca, prodhim të energjisë elektrike janë lëshuar në pajtim me obligimet ligjore që janë zbatuar nga ana e ZRRE sa i përket aspektit administrativ të shqyrtimit dhe mbështetur në lejet mjedisore të lëshuar nga Ministria e Ambientit dhe të sjella nga K.. . Sa i përket çështjes së ZRRE nuk ka zhvilluar konsulta publike nuk qëndron sepse edhe nga shkresat e lëndës kemi dëshmuar se publikimet për njoftim për licencim të aktiviteti të prodhimit janë publikuar sipas udhëzimeve të ZRRE-së nga gazeta ditore me dt.25.09.2019, ku këto prova të cilat gjinden në lëndë por edhe tani do ti bashkëngjisim dhe do ti japim secilës palë veç e veç. Konsideroj se kemi arritur të dëshmojmë nga shkresat e lëndës vlerësimin e provave sa i përket ZRRE janë zbatuar të gjitha kushtet dhe kriteret ligjore të dhëna me legjislacion primar të zbatueshëm dhe aktet nënligjore përfshirë rregullat dhe procedurat për lëshimin e licencave përkatëse”.*

Ndërkaq në fjalën përfundimtare deklaroi: *“Konsideroj se nga provat e administruara gjatë këtij shqyrtimi kryesore kemi arritur të dëshmojmë se padia e paditësit dhe e palës ndërhyrëse është e pa bazuar dhe se vendimet e atakuara me këtë padi janë vendime të ligjshme dhe të mbështetura me prova materiale. Po ashtu besojmë se Gjykata e shkallës së parë me rastin e marrjes së Aktgjyqimit do ti vërtetoi drejtë të gjitha provat materiale dhe formale pasi që konsiderojmë se vendimet e atakuara nga paditësi janë vendime të ligjshme, për më tepër e paditura ka ndjekur një veprim legjitim dhe vendimet e atakuara janë nxjerrë në pajtim të plotë me parimet ligjore të mbështetura në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, Legjislacionin e zbatuar dhe vendimet përkatëse të lëshuara nga Institucionet e Republikës së Kosovës. Mbështetur në nenin 34 par 1 nënpar.1.1 dhe 1.3 neni 44 dhe 46 par 2 të LKA-së, i propozojmë gjykatës të merr aktgjykim me të cilin refuzohet padia dhe kërkesëpafia e paditësit F. S. dhe palës ndërhyrëse e ushtruara kundre vendimeve të atakuara Vendimi nr.V.1302/2020 dhe Vendimi V1304/2020 i dt.12.11.2020 si të pa bazuara. Gjithashtu lusim gjykatën që të refuzohet kërkesa e paditësit për shpenzimet e përfaqësimit në kuptim të nenit 64 të LKA-së”.*

Pala e interesit, K.. E.. Sh.p.k. me përgjigjen në padi të datës 13.04.2023, e ka kontestuar në tërësinë padinë dhe kërkesëpadinë e paditësve duke pohuar, ndër të tjera se paditësit nuk kanë legjitimitet aktiv në procedurë, se padia është një shënjestër në lëvizje, se kualiteti i ujit në Deçan është 100% në përputhje me standardet përgjatë gjithë periudhës njëvjeçare të monitorimit. Pala e interesit, më tej, konsideron se nuk qëndrojnë pretendimet e palës paditëse sa i përket pala

çështjes së koncesionimit, këtë pretendim e cilëson absurd dhe se dallimi në mes të lejes ujore dhe koncesionit është shumë i qartë. Pala e interesit poashtu konsideron se pretendimet e paditësve se: “Ministria ka fshehë faktet dhe ka shkelë parimet ligjore, duke i mbajtur anën K.. it dhe duke shpërfillë kushtet e papërbushura”, janë kaotike. Shton se poashtu nuk qëndrojnë pretendimet e paditësve sa i përket pjesëmarrjes së publikut në proces, andaj i propozon Gjykatës që padinë ta hedhë poshtë si të palejuar apo të refuzoj padinë e paditësve si të pabazuar.

Në seancën e shqyrtimit kryesor, përfaqësuesi i palës së interesit, deklaroi: *“Referuar deklaramit të paditësve dhe ndërhyrësve përforcohet fakti se kjo padi dhe argumente e përdorura aty janë një shënjestër në lëvizje duke mos artikuluar qartë se cili është argumenti kryesor rreth paligjshmërisë së pretenduar të akteve administrative. Nga deklarimi i përfaqësueses së paditësve duket se është kuptuar se paditësit nuk kanë legjitimitet procedural aktiv dhe se legjitimiteti i tyre tani mundohet të sigurohet nëpërmjet ndërhyrësve. Ndërhyrësit nuk kanë pozitën e paditësve dhe si i tillë legjitimiteti aktiv procedural i ndërhyrësve në krahasim me paditësit buron nga dy baza të ndryshme. Referuar nenit 10 të LKA-së, paditësit kanë ngritur padinë duke vlerësuar se atyre i është cenuar një e drejtë apo interes ligjore, se sa dhe si i është cenuar interesi ligjorë dhe të drejtat ne kemi paraqitur argumentet tona në përgjigje në padi dhe në deklaramin në seancën e kaluar. Legjitimiteti për të qenë pjesë e procedurës për ndërhyrësit buron nga një bazë tjetër ligjore e asaj është par 2 i nenit 10 të LKA-së, pra në këtë rast ndërhyrësi nuk mund ta legjitimoj paditësit ashtu siç pretendohet. Sa i përket argumenteve të parashtruara në seancën e sotme rreth paligjshmërisë së pretenduar të akteve administrative për arsye se nuk është respektuar procedura e konsesionimi, ne rreth kësaj çështje jemi deklaruar në përgjigje padi, seancën e kaluara dhe në mbështetje të këtyre deklaramive ne i dorëzojmë gjykatës dhe palëve një provë shtesë pra një vendim të nënshkruar nga Kryeministri i R3epublikës së Kosovës i cili është kryesues i këshillit ndërministrues për ujëra ku në të cilin vendim thuhet se duhet të zbatohet procesi i dhënies së lejes ujore e kjo në mungesë të kuadrit ligjorë për dhënien e koncesioneve, ky vendimi është i dt.10.01.2018, dhe mban numrin KNMU/V/02/2017.*

Sa i përket argumentit të dytë se i është rrezikuar qasja në ujë të pijshëm për banorët e Deçanit e kjo referuar raportit ashtu siç pretendohet të departamenteve të ujërave e i cili raport është i para 9 viteve, theksojmë se fillimisht paditësit nuk kanë legjitimitet për të folur në emër të banorëve të Deçanit e po ashtu nuk janë të autorizuar të flasin në emër të KRU Hidrodrini e cila kompani publike ka organet e veta ka personalitet juridik dhe mund të paraqitet si palë e interesit. Prova nr.4 e dorëzuar nga paditësit e cila pretendohet se vërteton thëniet në këtë seancë nuk mund të cilësohet si dokument zyrtar ngase i njëjti nuk ka nënshkrim dhe për më tepër siç theksuam më lartë ky raport- nëse ai ekziston është i para 9 viteve dhe nuk ka të bëjë fare me aktet administrative të sfiduara në këtë konflikt administrativ. Sa i përket argumentit se nuk është respektuar pjesëmarrja e publikut, rreth kësaj çështje kemi deklaruar në seancën e kaluar dhe për neve mbetet befasese se si po insistohet në këtë argument kur janë dorëzuar prova si nga ne dhe ZRRE që dëshmojnë të kundërtën e këtij pretendimi. Sa i përket argumentit se lejet ujore janë lëshuar në kundërshtim me Ligjin për Ujerat ngase nuk është dorëzuar studimi i prurjes së pranueshme ekologjike, kjo gjë nuk është e vërtetë ngase ky studim është dorëzuar nga pala e interesit e cila edhe evidentohet në raport të grupit punues për hidrocentrale në faqen 28 pika 5.

Duke qenë se deri tani nuk jemi deklaruar rreth plotësimi të padisë të dorëzuar nga ndërhyrësi me dt.13.06.2022, palë e interesit e kundërshton këtë plotësim sepse i njëjti është në kundërshtim me nenin 258 të LPK-së, sepse ndërhyrësi nuk e ka pozitën e paditësit ashtu që ti lejohet plotësimi apo ndryshmi i padisë.

Sa i përket raportit të grupit punues për Hidrocentrale i njëjti parqet një perspektivë personale të individëve që kanë hartuar këtë raport e jo artikulum të qartë e profesional të një institucioni të autorizuar për të vlerësuar aktet administrative. Ky grup punues nuk mund të ketë mandatin ligjor për të vlerësuar vendimet e organeve të autorizuar për lëshim të akteve administrative siç është ARPL dhe Sekretari permanent i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë dhe Infrastrukturës ngase aktet administrative mundë të rishqyrtohen vetëm nga organi eprorë apo nga Gjykata. Për më tepër ka një paradoks institucional në këtë rrafsh ngase ky grup punues flet në emër të MMPHI ndërsa që vet Ministria i ka lëshuar aktet administrative e po ashtu organi kompetent për përfaqësim të interesave të ministrisë në këtë seancë u deklarua se këto akte administrative janë të lëshuara në mënyrë të ligjshme dhe të drejtë. Andaj ky raport nuk mund të konsiderohet si provë kredibile për arsye se është hartuar nga një organ i cili ligjërish nuk ekziston.

Për më tepër ajo çfarë kërkohet nga ky grup punues është që të veprohet në kundërshtim me parimin e sigurisë juridike dhe të anulohen aktet administrative të cilat janë të miratuara më shumë se 10 vite më parë e shembull për këtë është leja e ndërtimit.

Sa i përket provave të dorëzuara nga ana e paditësve gjithsejtë 13 provave të reja fillimisht nuk kemi arsyetim se cilit qëllim i shërbejnë këto prova dhe se si ato i shërbejnë vërtetimit të pretendimit të tyre. Shkurtimisht do të bëj elaborimin e disa nga provave të dorëzuara ndërsa elaborimin e hollësishëm do ta dorëzoj me shkrim. Sa i përket raportit të auditimit të performancës është e qartë se ky raport nuk e bënë vlerësimin e akteve administrative por e bënë vlerësimin e sistemit të ndërtuar nga ana e institucioneve për procesin e licencimeve të Hidrocentraleve dhe nëse shikohen konkluzionet e cilat janë 9, asnjëri nga to nuk është relevant për pretendimet e paditësve përveç konkluzionit nr.8 ku thuhet se Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor nuk ka bërë përpjekje për të zbatuar procesin e konsesionimit dhe për pasojë kishte vazhduar dhënien e lejeve ujore për shfrytëzim të ujit për HC-të. Megjithatë ZKA nuk i gjënë si të pa ligjshme lejet ujore por i ndërlidhë vetëm me humbje financiare që mund ti shkaktohet vendit e jo me paligjshmërinë absolute t tyre. Sa i përket raportit të Avokatit të Popullit nëse lexohet me vëmendje ky raport i shërben të kundërtës së argumentit të paditësve, kjo sepse kur flitet në këtë raport për kufizimin e qasjes në dokumente publike sa i përket procesit të licencimit të K.. Avokati i referohet kërkesës për qasje të bërë nga ana e ankuesit A. G. në K.K. Deçan e jo në Ministrinë e Mjedisit, pra sipas këtij raporti është K.K. Deçan ajo e cila ka dështuar në ofrimin e qasjes në dokumente publike, e që K.K. Deçan nuk është përgjegjëse për proces të licencimit. Sa i përket mos përfshirjes së publikut në vendimmarrje në këtë raport nuk përmendet fare procesi i licencimit të K.. por i referohet procesit të licencimit të një hidrocentrali tjetër në Shtërpcë ngase sipas përgjigjeve të dhëna nga Inspektorati i Mjedisit për Avokatin e popullit pjesëmarrja e publikut është siguruar. E po ashtu në këtë raport përmendet fakti se nuk ka pasur degradim të mjedisit sepse policia ndonëse ka zhvilluar hetime drejt kësaj vepre penale ka gjetur se nuk përmbushen elementet e kësaj vepre penale sepse nuk ka pasur degradim të mjedisit. Sa i përket provave të tjera dhe argumenteve tjera procedurale kërkojmë nga gjykata të na ipet kohë në afat prej 7 ditësh të dorëzojmë fjalën përfundimtare me shkrim”.

Ndërkaq në fjalën përfundimtare të dorëzuar me shkrim, deklaroi: “K. E..” Sh.p.k. (tani e tutje: Pala e Interesuar) është një ndër investitorët më të mëdhenj në Kosovë, i cili ka investuar më shumë se 60 (gjashtëdhjetë) milion EUR në ndërtimin e kapaciteteve për prodhimin e energjisë elektrike. Parashtruesi i kërkesës merret me prodhimin e energjisë elektrike nëpërmjet tre (3) hidrocentraleve të ndërtuara në luginën e Lumit të Deçanit (hidrocentrali Belaja, hidrocentrali Deçan dhe hidrocentrali Lumbardhi II), duke iu ofruar rreth pesëdhjetë mijë (50,000) familjeve kosovare energji të pastër. Njëherit, parashtruesi i kërkesës ka lidhur Kontratën për Blerje të Energjisë me ndërmarrjen shtetërore KOSST, ndaj të cilës ka detyrime bazuar në dispozitat kontraktuale, derisa nga zbatimi i asaj kontrate ka interesa ekonomike.

Sipas dispozitave të kornizës ligjore të Republikës së Kosovës, “K. E.” Sh.p.k. ka zhvilluar veprimtarinë e saj bazuar në vendimet përkatëse të organeve shtetërore, respektivisht të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë (tani e tutje: ZRRE), e cila në vazhdimësi ka lëshuar vendime të cilat i kanë mundësuar Parashtruesit të Kërkesës investimin në kapacitetet gjeneruese të energjisë elektrike nëpërmjet ndërtimit të infrastrukturës për hidrocentrale – investim ky që kap shifrën prej më shumë se 60,000,000 EUR (me fjalë: gjashtëdhjetë milion euro).

Së fundi, Parashtruesi i Kërkesës në mënyrë që të finalizoj të gjithë investimin e tij ka aplikuar dhe ka siguruar për lejet ujore, vendimet përkatëse për leje mjedisore si dhe licencat përkatëse për prodhimin e energjisë elektrike, të dhëna nga Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit (tani e tutje: MEA) dhe ZRRE, si në vijim: (i) Vendimi Leja Ujore (L.U.) për HC Belaja L.U.13,4981/20 dt.03.11.2020; (ii) Vendimi LU për HC Deçan L.U. 14,4982/20 dt.04.11.2020; (iii) Vendimi për Leje Mjedisore (L.M) për HC Belaja 19,5837/ZSP dt. 06.11.2020; (iv) Vendimi për LM për HC Deçani 19,5837/ZSP dt. 06.11.2020; (v) Vendimi i ZRRE-së për HC Deçan V-1303-2020 i dt. 12.11.2020; (vi) Vendimi i ZRRE-së për HC Belaja V-1304-2020 dt. 12.11.2020; (vii) Licenca për prodhimin e energjisë elektrike për HC Deçan LI-49/20 dt. 12.11.2020 dhe (viii) Licenca për prodhimin e energjisë elektrike për HC Belaja LI-50/20 dt. 12.11.2020 (tani e tutje: Vendimet e kontestuar të MEA-së dhe ZRRE-së).

Më 04.12.2020, F. S. (tani e tutje: paditësi i parë) ka inicuar konfliktin administrativ duke parashtruar padi ndaj Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit dhe Zyrës së Rregullatorit të Energjisë. Paditësit, më vonë i janë bashkangjitur edhe dy Paditës të tjerë, respektivisht Z. M.. L. dhe Xh.. K.. Paditësit nëpërmjet Padisë kanë kërkuar anulimin e vendimeve si në vijim: (i) Vendimi Leja Ujore (L.U.) për HC Belaja L.U.13,4981/20 dt.03.11.2020; (ii) Vendimi LU për HC Deçan L.U. 14,4982/20 dt.04.11.2020; (iii) Vendimi për Leje Mjedisore (L.M) për HC Belaja 19,5837/ZSP dt. 06.11.2020; (iv) Vendimi për LM për HC Deçani 19,5837/ZSP dt. 06.11.2020; (v) Vendimi për Leje Ujore për HC Lumbardhi II, nr. Prot. 5058 i dt. 03.02.2021 (vi) Vendimi i ZRRE-së për HC Deçani V-1303-2020 i dt. 12.11.2020; (vii) Vendimi i ZRRE-së për HC Belaja V-1304-2020 dt. 12.11.2020; (viii) Licenca për prodhimin e energjisë elektrike për HC Deçan LI-49/20 dt. 12.11.2020 dhe (ix) Licenca për prodhimin e energjisë elektrike për HC Belaja LI-50/20 dt. 12.11.2020.

Pas dy seancave të mbajtura. Palët e përfshira kanë propozuar edhe prova të reja me anë të së cilave pretendojnë se i vërtetojnë argumentet e tyre. K.. Sh.P.K. si Palë e Interesuar, në këtë konflikt administrativ, me respekt parashtron këtë Fjalë Përfundimtare

MUNGON LEGJITIMITETI PROCEDURAL AKTIV I PADITËSVE

Së pari, Pala e Interesuar parashtron se Padia është ngritur nga persona të cilëve ju mungon legjitimiteti aktiv.

Sipas logjikës ligjore që rrjedh nga Nenit 10 dhe 18 të Ligjit për Konfliktet Administrative (në vijim: LKA), personat fizik dhe juridik që paraqiten si paditës në kapacitetin e tyre personal në Konflikt Administrativ, duhet të dëshmojnë shkeljen e interesave të tyre direkte dhe/apo indirekte. Në këtë frymë, Padia, kur paraqitet nga një person fizik, duhet të mbështetet nga prova konkrete të cilat dëshmojnë që atij/asaj është duke i është shkelur ndonjë e drejtë apo interes ligjor. Në rastin konkret, standardi minimal për të pretenduar se një person fizik është duke u dëmtuar nga vendimet e atakuara është që të ofrojë prova konkrete se si ai apo ajo personalisht është duke u dëmtuar, e që Paditësit kanë dështuar të bëjnë një gjë të tillë.

Duke qenë se asnjëri nga Paditësit nuk e kanë vërtetuar interesin e drejtëpërdrejtë – mund të thuhet se Paditësit kanë paraqitur Padinë, jo në kapacitetin e tyre personal, por për të mbrojtur interesin e përgjithshëm, si botën bimore, kafshët dhe bujqësinë. Në aspektin ligjor, paragrafi 2 i Nenit 10 të LKA ka caktuar ekskluzivisht këtë kompetencë entiteteve tjera juridike. Kështu, ky paragraf qartë thekson se Organet e administratës, Avokati i Popullit, shoqatat dhe organizatat e tjera, të cilat veprojnë në mbrojtje të interesave publike mund të fillojnë konfliktin administrativ në rastet kur një akt administrativ ka shkelur ndonjë interes direkt apo indirekt.

Paditësi nuk bëjnë asnjë referencë në ndonjë provë materiale për të vërtetuar faktin se me vendimet kontestuese të MEA-së dhe ZRRE-së, paditësve po iu cënohet uji i pijes. Po ashtu, paditësi F.. S.. asnjëherë nuk ka parashtruar “autorizimin”, për të dëshmuar se ai po i parashtron mjetet juridike në emër të qytëtarëve të Deçanit. Krahas kësaj, paditësi F.. S.. nuk ka ofruar fletën poseduese se ai është pronar i ndonjë toke në afërsi të hidrocentraleve, apo edhe ndonjë studim apo hulumtim shkencor, për të dëshmuar se toka bujqësore, pronar i së cilës pretendon të jetë, “po rrezikohet” nga operimi i hidrocentraleve.

Njësoj, lidhur me paditësin e dytë, M..L., nuk ka ofruar prova se i njëjti është pronar i tokës ku është ndërtuar HC Bellaja. Përkundrazi, Pala e Interesuar ka dorëzuar Aktgjykimin e Gjykatës Supreme AC – I – 16 – 0183 – A0001, me të cilin me vendim të formës së prerë është refuzuar padia e M..L., e ushtruar ndaj palëve që pretendohet se ia kanë penguar të drejtën në gezimin e asaj prone. Për më tepër, sfidimi i akteve administrative kontestuese nuk është lëndor me pretendimin që e ka Paditësi M..L.. I njëjti poqese është pronar i paluajtshmërisë sipas pretendimit – ka mundur të ushtroj padi për pengim posedimi, apo alternativisht për lirim të pronës dhe/apo kompensim dëmi – e jo të ushtroj padi për anulimin e akteve administrative për mbrojtjen e të drejtave të tij të pretenduara pronësore.

Sa i përket Paditësit Xh. K., i njëjti vetëm ka deklaruar se gypat e hidrocentraleve janë shtrirë në pronën e tij 159-0. Megjithatë, i njëjti nuk ka ofruar asnjë provë. Në anën tjetër, Pala e Interesuar ka parashtruar prova materiale për të vërtetuar të kundërtën e këtij pretendimi, ndër

të tjera: a) pamjen nga gjeoportali i parcelës 159-0 dhe b) shtegun e ndërtuar të kanalit, sipas të cilave është bërë shtrirja e gypave të hidrocentralit duke shmangur parcelën private 159-0. Andaj, kjo deklaratë është vetëm pretendim i pambështetur në asnjë provë. Po ashtu edhe ky Paditës po qese Pala e Interesuar ka shtrirë infrastrukturën e saj në tokën ku ai është pronar – ka mundur të ushtroj padi për pengim posedimi, apo alternativisht për lirim të pronës dhe/apo kompensim dëmi – e jo të ushtroj padi për anulimin e akteve administrative për mbrojtjen e të drejtave të tij të pretenduara pronësore.

Ngastrat kadastrale ku është e shtrirë infrastruktura e Palës së Interesuar janë të evidentuara qartë. Kjo evidentohet nëpërmjet kontratës për shfrytëzimin e pronës së paluajtshme të Komunës së Deçanit sipas Kontratës së Servitutit për ndërtimin dhe operimin e njësisve gjeneruese hidroenergjetike të lidhur në mes të palëve K.. Energy Sh.P.K., dhe komunës së Deçanit që në vitin 2012, si dhe me Kontratën për Shfrytëzimin e Tokës Pyjore të lidhur në mes të K.. Energy Sh.P.K., dhe Agjencisë Pyjore të Kosovës. Aty janë të evidentuara të gjitha ngastrat kadastrale dhe në mesin e tyre nuk gjindet ngastra e Paditësit Xh. L..

Çështja e legjitimitetit të paditësve është ngritur në procedurën e “Shtyerjes së Ekzekutimit të Vendimeve” pranë të gjitha instancave gjyqësore-përfshirë edhe Gjykatën Kushtetuese. Gjykata e Apelit dhe Gjykata Kushtetuese i janë referuar specifikisht çështjes së legjitimitetit të palëve Paditësve, të cilat janë në të njëjtën linjë të argumentimit sikurse ato të Palët së Interesuar. Krahas argumenteve të parashtruesit të kërkesës lidhur me mungesën e legjitimitetit aktiv të paditësve, Gjykata se Apelit në Aktvendimin AA.nr.2/21 të dt. 14.01.2021, thekson se “Gjykata e shkallës së parë nuk ka dhënë asnjë arsyetim dhe nuk e ka spjeguar raportin që Paditësi e ka me të Paditurat me qëllim që të vërtetohet drejtë legjitimiteti aktiv i palës paditëse dhe interesi i tij”. Më tutje, Gjykata e Apelit me të drejtë ka gjetur se “[...] nuk dihet në çfarë cilësie Paditësi flet edhe në emër të banorëve pasi që nuk është i autorizuari i tyre dhe nuk është dëshmuar se i njëjti i përfaqëson ata”.

Ndërsa, në Aktvendimin AA.Nr 320/21 të dt. 26.04.2021, Gjykata e Apelit ka konstatuar: “paditësit – propozuesit në asnjë rrethanë nuk e [kanë dëshmuar] dëmin e drejtpërdrejtë apo të tërthortë që do t’ju shkactohej në rast të ekzekutimit të vendimeve të kontestuara” – duke iu referuar vendimeve të MEA-së dhe ZRRE-së.

Ajo çfarë është më e rëndësishme, Gjykata Kushtetuese e Kosovës, me datën 14 Nëntor 2022 ka nxjerrë Aktgjykimin me numër të referencës: AGj 2076/22¹ me anë të së cilës konstatoi se Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme [ARJ.UZVP.Nr.74/21] (i cili i referohet Shtyerjes së Ekzekutimit të Vendimeve), i 28 korrikut 2021, është nxjerrë në kundërshtim me garancitë procedurale të përcaktuara me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, për shkak të mungesës së vendimit të arsyetuar gjyqësor, duke e kthyer çështjen për rishqyrtim në Gjykatën Supreme.

Argumenti kryesor mbi të cilën e kishte marrë Gjykata Kushtetuese vendimin në fjalë, është fakti se Gjykatat më të ulëta, nuk kishin adresuar pretendimin kryesor të Palët së Interesuar – atë se nuk është dhënë përgjigje specifike në pretendimin në mungesën e legjitimitet procedural të palës

¹ Aktgjykimi AGj 2076/22

paditëse (paragrafi 139 dhe 140 i Vendimit AGj 2076/22). Më konkretisht, Gjykata duke dhënë një vlerësim të tërësishëm të rrethanave të rasti konkret, konstatoi se, Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme nuk ka adresuar plotësisht dhe në mënyrë të qartë (i) faktet vendimtare dhe kushtet ligjore lidhur me lejimin e shtyrjes së ekzekutimit të vendimeve të MEA-së dhe ZRRE-së; si dhe (ii) nuk ka dhënë përgjigje specifike në pretendimin e parashtruesit të kërkesës lidhur me mungesën e legjitimitetit procedural të palës paditëse. Sipas Gjykatës Kushtetuese, të dy këto aspekte, reflektojnë pretendime thelbësore dhe përcaktuese të parashtruesit të kërkesës, të cilat, bazuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës dhe Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, duhet që domosdoshmërisht të adresohen dhe arsyetohen nga gjykatat, në mënyrë që të respektohen garancitë procedurale të përcaktuara me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Më tutje, Gjykata Kushtetuese ka vlerësuar se “duke pasur parasysh pretendimet e palës paditëse mbrojnë edhe interesat e banorëve të Deçanit – çka në të vërtetë janë pretendime për mbrojtje të interesit publik që sipas dispozitave ligjore të LKA-së mund të mbrohet vetëm nga organi i administratës, Avokati i Popullit, shoqatat dhe organizatat tjera. (paragrafi 131 i Aktgjykimit).

Legjitimiteti procedural aktiv i palëve paditëse nuk sigurohet as nëpërmjet Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit – pasi që sipas këtij ligji, personave fizik mund të kërkojnë mbrojtje gjyqësore atëherë kur pësohet dëm material apo ekziston rreziku i shkakimit të dëmit material – gjë që në këtë rast nuk ka pretendime të tilla të palëve.

Në këtë proces gjyqësor, Gjykata me datën 12 Mars 2021, ka aprovuar kërkesën për ndërhyrje të dy Organizatave Joqeveritare, Grupit për Studime Juridike dhe Politike dhe Pishtarët. Në seancën e datës 11 Maj 2023, përfaqësuesja e autorizuar e Paditësve dhe e Ndërhyrësve ka tentuar të argumentoj ekzistimin e legjitimitetit aktiv procedural të palëve. Megjithatë, nga argumentimi i përfaqësues, qartazi kuptohet se në fakt është kuptuar tanimë se Paditësit nuk kanë legjitimitet procedural aktiv – edhe në frymën e gjetjeve të Gjykatës Kushtetuese. Megjithatë, përfaqësuesja argumentin e saj e shtron duke tentuar që të provoj se nëpërmjet ndërhyrësve sigurohet legjitimiteti i Paditësve. Një gjë e tillë është tërësisht joligjore dhe kontradiktore. Kjo pasi që pozita procedurale e ndërhyrësit nuk është Paditës. Paditësi dhe ndërhyrësi duhet të kenë interesa të njëjta në një vendim gjyqësor – por pozita e tyre procedurale ndryshon. Ndërhyrësi nuk mund të legjitimoj e as ta deligjitimoj Paditësin. Andaj, duke qenë të vetëdijshëm për këtë fakt – përfaqësuesja e Paditëse të gjithë argumentin lidhur me ekzistimin e legjitimitetit procedural të Paditësve e argumenton duke i'u referuar në fakt të drejtës së Ndërhyrësve për të ushtruar padi.

Andaj, pa paragjykuar argumentet në vijim, Gjykata vetëm mbi këtë bazë do të duhej të vepron në përputhje me nenin 34 par. 1, nënparagrafi 1.3 të LKA-së, dhe të hedhë poshtë Padinë si të palejuar, ngase e njëjta është paraqitur nga persona të cilëve nuk u preken të drejtat apo interesi i drejtëpërdrejtë.

ASPEKTET MATERIALE TË PADISË

Ndonëse Padia karakterizohet me një argumentim kaotik, dhe si e tillë është një shënjestër në lëvizje duke mos pasur një pretendim të qartë, Pala e Interesuar me respekt do të parashtroj përgjigje në të gjitha çështjet e ngritura nga ana e Paditësve.

Në pjesën ku Padi tësist pretendon shkelle ligjore, fillimisht bëjnë recitim tërësisht të panevojshëm të dispozitave kushtetuese ligjore tërësisht pa kontekst dhe pa vend.

Padi tësist i sfidojnë gjithsejt 9 (nëntë) akte administrative. Megjithatë, në argumentim ofrojnë vetëm pretendime të përgjithshme, duke mos i konkretizuar se si ato pretendime aplikojnë në raport me aktet e veçanta administrative të cilat sfidohen. Pra, kjo Padi më shumë ngjanë në një manifest politik kundër hidrocentraleve se sa në një dokument juridik me argumente e prova konkrete për të dëshmuar shkeljen e ndonjë të drejte apo interesi juridik konkret – nëpërmjet akteve administrative të sfiduara.

A. Pretendimi se Lejet Ujore janë dhënë në kundërshtim me ligjin

Janë tre argumente kryesore që i shtrojnë Padi tësist në Padi në raport me pretendimin e tyre se Lejet Ujore janë dhënë në kundërshtim me ligjin. Këto argumente janë: 1) këto leje ujore rrezikojnë ujin për pije dhe ujitje; 2) burimet ujore nuk mund ti “ipen biznesit privat pa konkurs”; dhe 3) Ministria ka fshehtë faktet dhe ka shkelë parimet ligjore, duke i mbajtur anën K.. it dhe duke shpërfillë kushtet e papërbushura”.

Sa i përket argumentit të parë: Padi tësist theksojnë ndër të tjera se “ligji nuk lejon hidrocentral që rrezikon ujin për pije dhe ujitje” – duke theksuar tutje se “lejet ujore qartazi shpërfillin nevojat e banorëve të trevës për ujë të pijes e ujitjes”.

Këto pretendime të Padi tësist janë të karakterit deklarativ dhe ato nuk përmbushin as standardin minimal të të provuarit gjyqësor. Jo rastësisht Padi tësist nuk i kanë bashkangjitur anjë provë të vetme për të vërtetuar pretendimet e veta.

Nuk është ofruar as edhe një dokument zyrtar, hulumtim shkencor, profesional, kombëtar apo ndërkombëtar mbi të cilin do të mund të bazoheshin pretendimet e Padi tësist. Padi tësist dështon të ofrojë ndonjë dëshmi që do të provonte që ka rrezik faktik për një dëm të madh dhe vështirë të riparueshëm që ekzekutimi i vendimeve do të mund t'i sillte lumit.

Padi tësist përmendin tri çështje në “argumentimin” e tyre. E para, “rreziku për kualitetin e ujit” të lumit është krejtësisht e pabazuar – e vërteta është krejt e kundërta e kësaj që thuhet. Kualiteti i ujit mbetet i pacënuar duke qenë se procesi i gjenerimit të energjisë elektrike përmes hidrocentraleve ‘runoff’ shfrytëzon një infrastrukturë (marrje, pendë, turbinë), e cila e izolon ujin e lumit prej çdo kontakti me substanca tjera të cilat mund të ndikojnë në kualitetin e ujit. Ky është standardi teknologjik për të gjitha hidrocentralet në mbarë botën. Andaj, përveç dështimit në argumentimin e tyre me prova, argumenti se Pala e Interesuar nëpërmjet hidrocentraleve e cenon kualitetin e ujit nuk ka as bazë logjike e as shkencore.

Çështja e dytë e ngritur nga Padi tësist është “rreziku për qasje në ujë të pijshëm”. Ky pretendim jep një indikacion ç’orientues se uji i lumit përdoret për furnizim me ujë të pijshëm për banorët e Deçanit. Kjo nuk qëndron. Sistemi i ujit të pijes i Deçanit – dhe fshatrave përreth – është krejtësisht i ndarë nga lumi i Deçanit. K.. Energy ka rikonstruktuar komplet sistemin e ujit të pijshëm si pjesë e një marrëveshje me Komunën e Deçanit në vitin 2015. Dokumentacioni i detajuar i ndërtimit e dëshmon faktin që sistemi i ujit të pijes është krejtësisht i ndarë. Hidrodrini, në mënyrë të suksesshme e operon këtë sistem që nga viti 2015 dhe mbanë përgjegjësinë për kualitetin e ujit dhe menaxhimin me të.

Raporti vjetor i kualitetit të ujit i përpiluar nga Hidrodrini për vitet 2017, 2018 dhe 2019, tregon që Hidrodrini është i rankuar më së miri sa i përket kënaqshmërisë së konsumatorëve me ujë të pijshëm. Në rajonin e Deçanit kualiteti i ujit ka qenë 100% në përputhje me standardet përgjatë gjithë periudhës një-vjeçare të monitorimit. Kjo nënkupton që asnjë ankesë zyrtare nuk është bërë në lidhje me kualitetin e ujit të pijshëm në Deçan. Ky fakt e kontradikton edhe një "argument" tjetër të Paditësit në lidhje me ankesat e banorëve. Edhe sikur të kishin ekzistuar ankesa të tilla, ato nuk mund të ndërlidhen me operimin e hidrocentralëve pasi që nuk ka kurrfarë lidhje fizike mes tyre dhe ujit të pijshëm.

Duhet pasur parasysh që në të gjithë Kosovën, furnizimi me ujë të pijshëm kryesisht nuk mirret nga lumi. Përkundrazi, në të gjithë Kosovën vetëm 2.34% e ujit të pijshëm nxirren nga lumenjtë. Në Deçan kjo përqindje është 0 (pra 0%), pasi që furnizimi me ujë të pijshëm bëhet ekskluzivisht nga burimet malore përgjatë luginës së Deçanit.

Çështja e tretë e Paditësit është "rreziku për qasje në ujitje". Përesëri, ky prezumim është ç'orientues, pasi që situata faktike qëndron ndryshe. Sistemi i ujitjes në Deçan e ka një kanal të veçantë të mbledhjes nga shtrati i lumit, që ndodhet afër urës së KFOR-it. Kjo pikë ndodhet poshtë lumit ku gjendet instalimi i fundit i K.. Energy dhe rrjedhimisht ka qasje të plotë në ujin e lumit të Deçanit përgjatë gjithë vitit. Thjesht duke u nisur nga arsye orografike, hidrocentralet nuk e afektojnë sasinë e ujit për ujitje në asnjë mënyrë.

Andaj, operimi i hidrocentralëve në Lumin e Deçanit nuk e afekton sasinë e ujit në asnjë mënyrë. E nejtja sasi e ujit që hyn në sistem nëpërmjet tubit, del jashtë dhe rrjedhë prap në lum pas turbinave. Andaj, çdo pretendim se operimi me hidrocentrale zvogëlon sasinë e ujit apo e mbanë ujin nga lumi në deponi sekrete është i pabazë dhe kjo është lehtësisht e provueshme.

Paditësit paraqesin prova ç'orientuese - fotografi - që i përkasin periudhës gjatë kohës sa hidrocentralet ishin duke u ndërtuar (ndërtimi i të cilave ka përfunduar në vitin 2015, dhe që nga atëherë është bërë rehabilitimi i gjërë). Ka një arsye të mirë që Paditësit dështojnë të ofrojnë prova reale lidhur me gjendjen momentale të ambientit përreth - tani që është i rehabilituar. Edhe pse kjo rrethanë nuk është relevante për vendimet në fjalë, duhet të nënvizohet fakti se e gjithë faza e ndërtimit dhe e rehabilitimit është monitoruar për së afërmi nga ekipet inspektuese të Ministrisë së Mjedisit. Nëpërmjet nxjerrjes së Lejes Mjedisore për të dyja hidrocentralet në Deçan dhe Belaje, K.. Energy ka pranuar edhe aprovimin zyrtar se rehabilitimi është përfunduar në mënyrë të suksesshme. Të gjitha këto janë të adresuara në Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis të projektit, i cili shërben si një udhërrëfyes afatgjatë për autoritetet dhe për K.. Energy. Ky argument crucial i implementimit të projektit nuk përmendet fare nga ana e Paditësit – pasi që kjo do të kontradiktonte të gjitha akuzat e tyre.

Duhet të nënvizohet fakti se Ministria e Mjedisit ka kërkuar që në kontekst të Lejeve Mjedisore të ofrohet një dokumentim nëpërmjet fotografive, të cilat shërbejnë për të krahasuar situatën gjatë fazës së ndërtimit (2013-2015) dhe statusit të rehabilitimit 2020. Pa asnjë dyshim, Paditësi – ashtu si çdo qytetar i Kosovës – do të mund të merrte foto nga faza e rehabilitimit përgjatë luginës së Deçanit.

Duke u bazuar në provat e mbështetura në fakte që u trajtuan më lartë, bëhet e qartë se argumenti qëndror i Paditësit se banorëve të Deçanit u rrezikohet qasja në ujë të pijshëm apo për ujitje për shkak të operimit me hidrocentrale është i pabazë.

Për më tepër, çdo efekt anësor i mundshëm teknik apo mjedisor që mund të vijë nga gjenerimi nëpërmjet hidrocentraleve, janë trajtuar në Lejet Ujore, të lëshuara nga autoritetet kompetente. Korniza ligjore ka dispozita të qarta, që sigurojnë monitorimin e vazhdueshëm të aktiviteteve për të cilat është dhënë leja si dhe sigurojnë parandalimin e dëmeve që mund të shkaktohen. Në lidhje me këtë, vendimet e Lejeve Ujore përmbajnë dispozita të qarta, përfshirë monitorimin e minimumit të nivelit të ujit, bazuar në kornizën e aplikueshme ligjore dhe administrative, që specifikojnë formula precize për kalkulimin e minimumit të nivelit të ujit në çdo periudhë të vitit për çdo segment të lumit. Në vitin 2018, K..Energy – në koordinim me autoritetin kompetent ujqor – ka instaluar stacione automatike për matjen e nivelit të ujit të cilat e bëjnë matjen pandërprerë – 24/7. Duke qenë në këto rrethana, secila prej kërkesave të Paditësit në lidhje me këtë pikë janë përmbushur tashmë sipas kërkesave që dalin nga rregullativa ligjore.

Duke u bazuar në Lejet Ujore, Zyra e Rregullatorit për Energji (“ZRRE”) ka lëshuar licensat për prodhimin e energjisë elektrike për K.. Energy, siç është paraparë me ligjet e aplikueshme. Një kusht që është paraparë në licensë, është mbrojtja e mjedisit dhe poashtu obligimi i përvjetshëm për raportim lidhur me aktivitetin mjedisor pranë ZRRE-së. [Neni 14 i Licensave për Prodhimin e Energjisë Elektrike].

Vetëm nga një lexim i thjeshtë i kushteve që janë vendosur në Lejet Ujore dhe kushteve e obligimeve të vëna nga licensat për prodhimin e energjisë elektrike, Gjykata ka prova të mjaftueshme se i) korniza ligjore është aplikuar në përpikmëri dhe kështu ii) nuk rrezikohet uji për pije dhe ujitje.

Rrjedhimisht pretendimet e Paditësit se lumi po vihet në rrezik, janë të pambështetura në prova dhe janë faktikisht e edhe juridikisht të pathemelta dhe absurde. E gjithë kjo le të kuptohet se padia nuk është përgatitur bazuar në fakte dhe në njohuri substanciale të rregullativës ligjore por është përgatitur nga njerëz joprofesionistë, pa pasur ndonjë njohuri (e as prova nga vendi i ngjarjes) se çfarë është realisht impakti i hidrocentraleve në ujën e lumit të Deçanit. Duket se të gjitha pretendimet thjesht adresojnë akuzat e pabaza të individëve të caktuar. Baza shkencore dhe/apo profesionale për t’i mbështetur këto akuza mungon.

Gjatë procedurës gjyqësore, Paditësit kanë ofruar pretendime të reja mbështetur me “prova” të reja për të vërtetuar këto pretendime. Paditësit dorëzojnë si provë një “Raport” të Departamentit të Ujërave të datës 16 Maj 2014, me anë të së cilit pretendojnë se vërtetojnë këto pretendime. Hartues i pretenduar i këtij raporti është Elbasan Shala. Paditësit në seancën e datës 11 Maj 2023 kanë ngritur argumentet si në vijim: “me rastin e ndërtimit të projektit janë vendosur kabllot elektrike mbi rrjetin e shtrirjes së ujësjellësit të Komunës së Deçanit si dhe janë dhënë kontaktime se ka humbur një burim i ujit të pijes që furnizon me ujë banorët e KK Deçan.

Ashtu siç theksuam më lartë, Paditësit i referohen një dokumenti i cili mban datë 16 Maj 2014. Pala e Interesuar e konteston ekzistimin e këtij dokumenti. Kjo ngase, ky dokument nuk ka elementet e nevojshme për tu konsideruar si raport zyrtar, ngase i njëjti as nuk është i nënshkruar e as vulosur nga asnjë organ kompetent. Për më tepër, referuar datës së hartimit të pretenduar

të tij, i njëjti nuk është fare relevant – ngase është i para se më shumë se 9 viteve. Po ashtu, përmbajtja e këtij raporti nuk lidhet me argumentin kryesor të paditësit.

Më tutje, Paditësit i referohen disa emailave fiktiv të pretenduara se janë shkëmbyer në mes të një personi të quajtur Sh. L. me email shpresal@gmail.com; dhe një personi tjetër me emrin A. T.– i cili në nënshkrim paraqitet si Kryeshef Ekzekutiv i KUR ‘Hidrodrini’ Sh.A. Pala e interesuar me respekt parashtron se këto emaila nuk kanë fuqi provuese. Kjo së pari pasi që asnjëri nga personat të cilët pretendohet se kanë komunikuar nuk janë dëgjuar si dëshmitar. Së dyti, nëse shikohen datat kur janë shkëmbyer këto emaile vërehet se nga emaili shpresal@gmail.com pyetja është dërguar me datën 28 Mars 2023 në ora 06:08 am, ndërsa përgjigja nga emaili a.tigani@hidrodrini.com ka ardhur një ditë më heret, respektivisht me datë 27 Mars 2023, në ora 11:57 p.m. pra, së pari është kthyer përgjigja e pastaj është bërë pyetja!

Në anën tjetër, K.U.R “Hidrodrini” Sh. A. është institucion publik profesional i licencuar nga Autoriteti Rregullator për Sherbime të Ujit, për ofrimin e shërbimeve baze, të furnizimit me ujë të pijshëm dhe shërbimet kanalizimit. K.U.R Hidrodrini nga data 31.05.2007 zhvillon aktivitetin si Shoqëri Aksionare dhe është e organizuar sipas rregullit ekzistues të ligjeve të Kosovës. Sipas Ligjit Nr.03/L-087 për Ndërmarrje Publike Hidrodrini është e rregulluar si Ndërmarrje Publike.

Duke qenë e tillë, kjo kompani është e licencuar nga Autoriteti Rregullator për Sherbime të Ujit, për ofrimin e shërbimeve baze, të furnizimit me ujë të pijshëm (<https://hidrodrini.com/per-ne/>), dhe duke qenë se kjo kompani ka organet e veta vendimmarëse, sikur të kishte pasur ndonjë pakënaqësi në raport me veprimet e Palës së Interesuar apo në raport me aktvendimet e sfiduara të MMPHI-së dhe ZRRE-së, e njëjta do të paraqiste ankesë dhe/apo padi për anulimin e këtyre vendimeve, apo do të paraqitej si palë me interes në favor të Paditësve. Asnjërin nga këto dy veprime nuk i ka bërë KRU Hidrodrini – e për më tepër nuk ka autorizuar përfaqësuesen e Paditësve dhe Ndërhyrësve që të deklarohet për dhe në emër të tyre. Andaj, çdo deklaram në emër të kësaj kompanie duhet të refuzohet nga Gjykata.

Pretendimi i dytë material i Paditëseve se burimet ujore nuk mund ti “ipen biznesit privat pa konkurs”. Narrativa e Paditësve është se “Palës së Interesuar” nuk është guxuar të i ipet leja ujore, por vetëm ndarja e koncesionimit, pasi që “kjo është mënyra e vetme me anë të së cilës entiteteve privat i lejohet shfrytëzimi i uji”.

Ky pretendim është absurd! Ligji, thjeshtë nuk e parasheh një gjë të tillë. Ndonëse, kjo çështje është aq e qartë sa që sipas Palës së Interesuar as nuk ka nevojë që të argumentohet, megjithatë, për hirë të evidentimit të argumentit, Pala e Interesuar sqaron si në vijim:

Sipas definicionit të dhënë nga Ligji 04/L-147 për Ujërat (“Ligji për Ujërat) – “Leje ujore” - është e drejtë e dhënë me shkrim nga instituconet e përcaktuara me këtë ligj për të përdorur apo shkarkuar një sasi uji për një qëllim dhe kohë të caktuar. Pra, në vet definicion nuk përmendet e leja ujore ipet vetëm për entitetet publike.

Tutje, në nenin 72 të Ligjit për Ujërat përcaktohet se Leja Ujore lëshohet për, inter alia, përdorimi i ujërave me qëllim të shfrytëzimit të energjisë elektrike dhe gjeotermale. Edhe në këtë dispozitë nuk ceket se leja ujore lëshohet vetëm për entitetet publike.

Dallimi në mes të lejes ujore dhe koncesionit është shumë i qartë. Kjo e fundit i referohet projekteve që autoritetet publike dëshirojnë të implementojnë. Për më tepër, këto i nënshtrohen një legjislacioni të veçantë² - lex specialis – e cila e rregullon kornizën ligjore për partneritet publiko privat duke përfshirë procedurat për të hyrë në një partneritet publiko privat, përmbajtjen dhe strukturën e marrëveshjeve për Partneritet Publiko Privat si dhe strukturën institucionale përgjegjëse për menaxhimin dhe zhvillimin e Partneritetit Publiko Privat në Republikën e Kosovës. Në këtë ligj është dhënë, ndër të tjera edhe 1) definicioni i koncesionit; 2) llojet e koncesioneve; dhe 3) procedurat e dhënies së koncesionit. Andaj, dispozitat e ligjit për Ujërat të cilat i referohen Paditësit e rregullojnë një fushë krejtësisht tjetër dhe nuk kanë të bëjnë me leje ujore.

Pala e Interesuar K..Sh.p.k. ka dorëzuar prova me të cilat është vërtetuar se Ministrisa e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor në vazhdimësi ka lëshuar leje ujore për aktivitete të ngajshme. Nëse i referohemi listës së lejeve ujore të lëshuara nga viti 2018-2021 të cilat janë Gjykatës si provë nga ana e Palës së Interesuar kuptohet se Leja Ujore ka qenë akti administrativ i cili është lëshuar gjithëmonë. Asnjëherë për aktivitete të ngajshme nuk është aplikuar procedura e koncesionit.

Në anën tjetër, me datën 01 Janar 2018, Kryeministri i Republikës së Kosovës si Kryesues i Këshillit Ndërmintor për Ujëra ka marrë vendimin me numër KNMY/V/02/2017 me anë të së cilit ka obliguar Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë që të zbatoj procesin e dhënies së lejeve ujore, e jo atë të koncesionimit.

Në tentativën e Paditësve për të argumentuar këtë qëndrim ligjor, të njëjtët kanë paraqitur dy prova: 1) Raportin e Auditimit të Performancës “sistemi i licencimit të hidrocentraleve dhe monitorimi i tyre mbi ndikimin në mjedis dhe ujëra) dhe 2) raport i grupit punues për “Shqyrtimin e Procedurave Administrative të Zbatuara për Hidrocentrale dhe Ndikimn e tyre në Ujëra dhe Mjedis”.

Sa i përket Raportit të Auditimit të Performancës, fillimisht Paditësit dështojnë që të argumentojnë në mënyrë konkrete se cilit qëllim apo argument i shërben. Përkundrazi, Paditësit vetëm se i hedhin këto raporte dhe emaila duke mos elaboruar pjesë të tyre të cilat pretendojnë se i shërbejnë qëllimeve të tyre.

Fushëveprimi i këtij Raporti nuk ka të bëjë me aktet administrative të sfiduara me Padi. Objektivë e këtij auditimi është vlerësimi nëse sistemi i licencimit të hidrocentraleve është menaxhuar si duhet, ofron transparencë dhe siguron mbrojtje të ujërave dhe të mjedisit. Ndërsa si qëllim i këtij raporti të auditimit është që të ipen rekomandime se si mund të avancohet sistemi i licencimit dhe ruajtja e mjedisit nga veprimtaria e HC-ve. Pra, ky raport ka të bëjë me një analizë të përgjithshme të sistemit të licencimit dhe vlerësimin se sa është i konsoliduar ky sistem, e nuk ka të bëjë me vlerësimin e akteve administrative të sfiduara.

Pra, që në hyrje të këtij raporti kuptohet se i njëjti nuk bënë vlerësimin e ligjshmërisë së akteve administrative – por ka për qëllim që të bëjë avancimin e sistemit të licencimit të veprimtarisë së HC-ve që është më se e mirëseardhur dhe i shërben adresimit të njërës nga gjetjes së parë

² Ligji për Partneritetin Publiko Privat

dhe kryesore që “Prodhimi i energjisë elektrike nga hidrocentralet është largë arritjes së cagueve vullnetare”. Në këtë raport potencohet se vetëm 100MË nga 240MË të planifikuara energji elektrike nga HC-të janë të arritur.

Megjithatë, edhe pse Padiësit nuk bëjnë referencë në pjesë të këtij raporti ku pretendohet se vërtetohen pretendimet e tyre, Pala e Interesit “K. E.” Sh.P.K., parashtron se ky Raport i shërben të kundërtës e asaj çfarë pretendojnë Padiësit.

Sa i përket konkretisht procesit të koncesionimit për shfrytëzimin e ujërave lidhur me prodhimin e energjisë elektrike, e gjetur e këtij raporti është se MMPHI nuk ka bërë përpjekje për të zbatuar procesin e koncesionimit dhe për pasojë kishte vazhduar dhënien e Lejeve Ujore për shfrytëzimin e ujit për HC-të pa zbatuar koncesionin. Megjithatë, këtë të gjetur ZKA e ndërlidhë vetëm me aspekte financiare e jo me paligjshmërisë së akteve administrative. Në asnjë pikë të këtij raporti të auditimit nuk pretendohet e lejet ujore janë të pavlefshme dhe/apo janë lëshuar në mënyrë joligjore.

Sa i përket të gjeturave të Raportit i grupit punues për “Shqyrtimin e Procedurave Administrative të Zbatuara për Hidrocentrale dhe Ndikimin e tyre në Ujëra dhe Mjedis”, Pala e Interesuar me respekt parashtron se i njëjti paraqet perspektivë personale të individëve të cilët e kanë hartuar këtë raport e jo artikulum profesional e përmbajtësor të një institucioni të autorizuar për të vlerësuar aktet administrative.

Fillimisht, duhet të potencohet se Gjykata duhet të bazoj vendimin e vet mbi argumentet dhe provat e propozuara nga palët e jo nga interpretimi i provave të paadministruara në gjykatë nga një grup punues – puna e të cilëve nuk gëzon mbështetje ligjore.

Ka një paradoks institucional sa i përket këtij raporti. Në njëërën anë, ky “grup punues” e paraqet raportin si “raport i ministrisë së mjedisit dhe planifikimit hapësinor” e në anën tjetër është vet kjo Ministri e cila i ka lëshuar lejet e sfiduara dhe mbron qëndrimin se lejet janë lëshuar në përputhje me ligjin. Poashtu, në bazë të përgjigjes në padi vet dhe deklarimit në seancë MMPHI thekson se e kundërshton padinë dhe kërkesëpadisë nën argumentin se lejet e sfiduara janë lëshuar në procedurë të ligjshme.

Ky Grup Punues nuk gëzon mbështetje ligjore e rrjedhimisht kjo provë nuk duhet të cilësohet si provë kredibile. Fillimisht nuk është dërguar ndonjë vendim me anë të së cilit është themeluar ky grup punues, andaj nuk kuptohet se nga buron e drejta e këtij grupi punues për të hartuar këtë raport.

Përveç kësaj, vet themelimi i këtij grupi punues (nëse ai ka ndodhur) paraqet një paradoks institucional. Asnjë grup punës nuk mund të vlerësoj punën e institucioneve kompetente siç është ARPL dhe Departamenti i Mjedisit brenda MMPHI-së, e poashtu grupi punues nuk mund të vlerësoj ligjshmërinë e akteve administrative. Ligji për Procedurën Administrative ka paraparë rregullat procedurale të shqyrtimit të ligjshmërisë së akteve administrative. Të njëjtën gjë e ka paraparë edhe Ligji për Konfliktet Administrative. Andaj, aktet administrative mund ti nënshtrohen vlerësimit të ligjshmërisë nga organet e prore, apo në rast se nuk ekziston një organ i tillë - nga Gjykata, e jo nga Grupet Punuese.

Ajo çfarë kërkon ky grup punes është që në kundërshtim me parimin e sigurisë juridike të bëhet rishikimi i akteve administrative të plotëfuqishme e të cilat në raste të caktuara janë lëshuar më shumë se dhjetë vite më herët.

Andaj, kjo provë nuk mund të trajtohet si provë kredibile nga Gjykata.

Pretendimi i tretë i Paditësve është se “Ministria ka fshehë faktet dhe ka shkelë parimet ligjore, duke i mbajtur anën K.. it dhe duke shpërfillë kushtet e papërmbushura”.

Argumentet në këtë rrafsh janë kaotike. Paditësit theksojnë se: 1) nuk është siguruar pjesëmarrja e publikut; 2) lejet janë lëshuar në afat rekord duke mos respektuar procedurat; 3) nuk janë plotësuar kushtet nga lejet paraprake, respektivisht nuk është sjellur elaborati i prurjes së pranueshme ekologjike. Asnjëra nga këto pretendime nuk janë të sakta.

Sa i përket pretendimit se nuk është siguruar pjesëmarrja e publikut, ky pretendim nuk qëndron pasi që ka pasur njoftime publike përgjatë gjithë procesit, ashtu siç kërkohet me ligjet në fuqi. Duket që Paditësit ose nuk kanë informacion të mjaftueshëm për krejt ecurinë transparente dhe ligjore të procesit, ose tentojnë ta fshehin atë.

Më 20 tetor 2010, ishte bërë njoftimi publik lidhur me aplikimin e K.. Energy pranë ZRRE për ndërtimin e tërë kaskadës së hidrocentraleve. Në këtë njoftim ishin ftuar të gjitha palët që nëse kanë vërejtje eventuale për këtë ndërtim, t’i adresojnë ato.

Më 24 qershor 2011 ishte publikuar njoftimi për debat publik lidhur me raportin e vlerësimit të ndikimit në mjedis që ndërtimi dhe funksionimi i hidrocentraleve ka.

Më 25 Shtator 2019 aplikimi për licencë të prdhimit të energjisë në ZRRE ishte bërë publik – nëpërmjet njoftimi përkatës publik që ftonte palët me interes që në rast se kanë ndonjë ankesë, ta paraqesin atë pranë ZRRE, pasi që K.. Energy veçse i kishte përmbushur të gjitha kushtet për t’u pajisur me licensë. Duhet të nënvizohet se asnjë akese e vetme nuk është paraqitur në ZRRE.

Andaj, pretendimi për mospërfshirjen e publikut nuk qëndrojnë.

Sa i përket pretendimit se “lejet janë lëshuar në afat rekord pa u respektuar procedurat”, poashtu një gjë e tillë nuk qëndron. Paditësit si duket nuk janë të informuar se procesit të lëshimit të lejeve dhe licencave i kanë paraprirë një mori të akteve administrative të organeve të ndryshme shtetërore duke filluar nga viti 2010, kur edhe e ka filluar investimin “Pala e Interesuar”. Ky investim në vlerë prej rreth 60, 000,000 EUR, ndër investimet më të mëdhaja në Kosovë, është realizuar duke u bazuar në lejet dhe licencat të cilat janë lëshuar nga viti 2010. Për të dhënë kontekst pretendimit të pabazuar të Paditësve se “lejet janë lëshuar në afat rekord”, pala e Interesuar në përgjigje në Padi ka parashtruar të gjitha aktet administrative dhe vendimet të cilat i kanë paraprirë akteve administrative të kontestuara me të cilat prova vërtetohet qartazi se vendimet e sfiduara janë rezultat i një procesi të gjatë e të rregullt administrativ, ndërsa që investimet e realizuara nga ana e Palët së Interesuar ishin të bazuara në vendime të ligjshme.

Sa i përket argumentit të tretë se nuk janë plotësuar kushtet nga lejet paraprake, respektivisht nuk është sjellur elaborati i prurjes së pranueshme ekologjike – as kjo nuk qëndron.

Ky kusht është përcaktuar me vet Lejet Ujore. Pika 11 e Lejeve Ujore përcakton se: Studimi i Prurjes së Pranueshme Ekologjike duhet të hartohet në përputhje me kërkesat e Rregullores së MMPH-së me nr. 02/2016 “Për mënyrën e Përcaktimit të Prurjes së pranueshme Ekologjike” në afat kohor prej 60 ditësh. Pra, Paditësit i referohen si “kusht i paplotësuar”, një kushti i cili do të duhej të plotësohej 60 ditë pas lëshimit të lejeve ujore. Kjo vetëm dëshmon se sa paradoksal është ky pretendim dhe e tërë padia e Paditësve.

B. Pretendimi se Lejet Mjedisore janë dhënë pa bazë, pa ecuri të rregullt dhe pa arsyetim. Më tutje, Paditësit pretendojnë se 1) lejet mjedisore janë dhënë duke u bazuar në leje ujore të cilat janë të paligjshme; 2) nuk ka arsyetim të mjaftueshëm për dhënien e lejeve ujore – respektivisht nuk janë adresuar pretendimet e palës kundërshtare; dhe 3) nuk është siguruar pjesëmarrja e publikut në vlerësimin e ndikimit në mjedis.

Sa i përket pretendimit të parë, se lejet mjedisore janë dhënë duke u bazuar në leje ujore të cilat janë të paligjshme – përgjigjet ndaj këtij argumenti i kemi dhënë më sipër. Nga argumentet e Palët së Interesuar qartazi shihet se lejet ujore janë të rregullta dhe të ligjshme.

Sa i përket pretendimit të dytë se nuk ka arsyetim të mjaftueshëm për dhënien e lejeve ujore, respektivisht nuk janë adresuar pretendimet e palës kundërshtare – ky argument nuk qëndron. Arsyetimi i dhënies së lejes mjedisore është mjaftueshëm i elaboruar dhe i referohet të gjitha akteve paraprake të cilat kanë shërbyer si bazë për nxjerrjen e këtyre vendimeve. Përveç kësaj, në këtë procedurë administrative nuk ka pasur palë kundërshtare – që të adresohen pretendimet e tyre.

Sa i përket përfshirjes së publikut – ashtu siç kemi theksuar më sipër – ajo ka ndodhur dhe pikërisht në procedurën e vlerësimit të ndikimit në mjedis. Lidhur me këtë Pala e Interesuar ka ofruar prova konkrete.

C. Pretendimi se Vendimet e Rregullatorit, janë në kundërshtim me ligjin dhe në shpërpjestim me qëllimin e lejuar.

Janë dy argumente kryesore që Paditësit i përdorin për të mbështetur pretendimi e tyre se këto vendime janë të dhëna në kundërshtim me ligjin, 1) licencat janë dhënë për 40 vite, ndërsa lejet ujore dhe mjedisore për 5 dhe 15 vite; dhe 2) ZRRE ka licencuar operimin e hidrocentraleve për të prodhuar gjithsej 8 MË, ndërsa që rrjedha e lumit e lejon vetëm prodhimin e 3MË.

Sa i përket argumentit të parë - këtu ekziston një mos-harmonizim i legjislacionit. Përderisa legjislacioni i energjisë e lejon licencimin për periudha deri në 40 vite, legjislacioni nuk e lejon dhënien e lejeve mjedisore dhe lejeve ujore për këtë periudhë. Në anën tjetër, Rregullatori nuk lëshon licenca pa poseduar lejen mjedisore dhe lejen ujore. Në këtë aspekt, sipas logjikës së përdorur nga Paditësit – Rregullatori nuk do të duhej të lëshoj licenca për prodhimin e energjisë elektrike që do të shkonin përtej periudhës 5 vjeçare. Ky pretendim është i pasaktë – pasi që kjo do të prodhonte situata kur asnjë operator nuk do të investonte për shkak të kohëzgjatjes së licencave!

Kjo pasi që Rregullatori në çdo rast kur operatori i licencuar gjatë operimit nuk do të përmbushte ndonjërin nga kushtet e licencimit (p.sh. në rast se nuk do të vazhdohej leja

mjedisore apo ujore), ka të drejtë që të revokoj vendimin për licencë. Kjo është e rregulluar me ligjin për procedurën administrative dhe nuk ka nevojë të specifikohet fare në licencë.

Sa i përket argumentit se ZRRE ka licencuar operimin e hidrocentraleve për të prodhuar gjithsejt 8 MË, ndërsa që rrjedha e lumit e lejon vetëm prodhimin e 3MË – ky argument nuk është i mbështetur me asnjë provë apo raport zyrtar apo shkencor. Si i tillë, ky pretendim mbetet vetëm deklarativ!

D. Provat e tjera të propozuara nga Paditësit

Paditësit nëpërmjet një parashtrese të datës 27 Prill 2023, ka dorëzuar gjithsejtë trembëdhjetë (13) prova të reja. Në këtë parashtrësë nuk është specifikuar se cilat pretendime mëtohet që të vërtetohen nëpërmjet këtyre provave. Megjithatë, prima facie, provat e tilla janë tërësisht të parëndësishme në raport me pretendimet e paditësve. Megjithatë, ne në vijim do të tregojmë se në fakt ato e vërtetojnë të kundërtën e pretendimeve të Paditësve.

Nëse i referohemi raportit të Avokatit të Popullit 365/2018, i njëjti ka zhvilluar hetime lidhur me kufizimin e të drejtës së qasjes në dokumente lidhur me hidrocentralet e Deçanit A. 753/2018, si dhe lidhur me kufizimin e së drejtës për qasje në dokumente lidhur me hidrocentralet e Shtërpcës A. 576. /2019. Avokati i Popullit, nga analiza e rastit vëren se institucionet përgjegjëse në vazhdimësi i janë shmangur detyrimit për të dhënë informacione lidhur me proceset në kuadër të kompetencave që kanë të bëjnë me hidrocentralet. Nga faktet e përcaktuara në raport lidhur me ankesat nr. 753/2018 dhe nr. 576/2019, vërehet se MMPH, tashmë MEE dhe Komuna e Deçanit duke mos ofruar qasje në dokumentet e kërkuara, ia mohuan shoqërisë civile të drejtën për qasje në dokumente publike.

Megjithatë, nëse i referohemi rasteve konkrete shohim se Avokati i Popullit nuk ka gjetur se nuk është respektuar përfshirja e publikut në rastin e marrjes së lejeve dhe licencave nga ana e Palët së Interesuar. Aty theksohet se MMPHI dhe Komuna e Shtërpcës kanë dështuar që të argumentojnë organizimin e dëgjimeve publike në rastin e ankesës që nuk ndërlihet me Hidrocentralet me të cilat operon Pala e Interesuar por me Hidrocentralet e tjera që nuk janë në rajonin e Deçanit (pika 95 e këtij Raporti). Andaj, në këtë raport pranohet se rreth ndërtimit të Hidrocentraleve në Deçan nga ana e Palës së Interesuar pjesëmarrja e publikut është siguruar (për çka ne kemi ofruar prova).

Sa i përket një rapori të Amnesty International – ky raport nuk i referohet procesit të licencimit dhe/apo të marrjes së lejeve – andaj, si i tillë nuk ka fare relevancë. Ky raport i referohet disa procedurave të tjera gjyqësore.

Sa i përket fotove të dorëzuara si prova, të njëjtat nuk kanë kurrfar relevance. Ato nuk janë pjesë e dokumentacioni të ndonjë procesi administrativ, por janë fotografi të marra nga vet Paditësit për të cilat nuk dihen se ku janë marr, ciles periudhë i takojnë apo se çka pretendohet që të vërtetohet nëpërmjet tyre.

Andaj, duke u bazuar në argumentet e dhëna më sipër, Pala e Interesuar me respekt i propozon Gjykatës që të merr Aktgjykim me anë të së cilës: Hedhet Poshtë si e Palejuar Padia e Paditëseve për Anulimin e Vendimeve të Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit dhe ZRRE, si në vijim: (i) Vendimi Leja Ujore (L.U.) për HC Belaja L.U.13,4981/20 dt.03.11.2020; (ii) Vendimi LU për

HC Deçan L.U. 14,4982/20 dt.04.11.2020; (iii) Vendimi për Leje Mjedisore (L.M) për HC Belaja 19,5837/ZSP dt. 06.11.2020; (iv) Vendimi për LM për HC Deçani 19,5837/ZSP dt. 06.11.2020; (v) Vendimi për Leje Ujore për HC Lumbardhi II, nr. Prot. 5058 i dt. 03.02.2021 (vi) Vendimi i ZRRE-së për HC Deçan V-1303-2020 i dt. 12.11.2020; (vii) Vendimi i ZRRE-së për HC Belaja V-1304-2020 dt. 12.11.2020; (viii) Licenca për prodhimin e energjisë elektrike për HC Decan LI-49/20 dt. 12.11.2020 dhe (ix) Licenca për prodhimin e energjisë elektrike për HC Belaja LI-50/20 dt. 12.11.2020, apo Refuzohet si e Pabazuar Padia e Paditëseve për Anulimin e Vendimeve të Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit dhe ZRRE, si në vijim: (i) Vendimi Leja Ujore (L.U.) për HC Belaja L.U.13,4981/20 dt.03.11.2020; (ii) Vendimi LU për HC Deçan L.U. 14,4982/20 dt.04.11.2020; (iii) Vendimi për Leje Mjedisore (L.M) për HC Belaja 19,5837/ZSP dt. 06.11.2020; (iv) Vendimi për LM për HC Deçani 19,5837/ZSP dt. 06.11.2020; (v) Vendimi për Leje Ujore për HC Lumbardhi II, nr. Prot. 5058 i dt. 03.02.2021 (vi) Vendimi i ZRRE-së për HC Decan V-1303-2020 i dt. 12.11.2020; (vii) Vendimi i ZRRE-së për HC Belaja V-1304-2020 dt. 12.11.2020; (viii) Licenca për prodhimin e energjisë elektrike për HC Deçan LI-49/20 dt. 12.11.2020 dhe (ix) Licenca për prodhimin e energjisë elektrike për HC Belaja LI-50/20 dt. 12.11.2020”.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, gjykata bëri administrimin e provave një nga një dhe të gjithave së bashku dhe atë: Vendimi për leje ujore me numër L.U.13 dt.03.11.2020, vendimi për leje ujore me numër L.U.14 dt.04.11.2020, vendimi për leje mjedisore me numër reference 5837/19/MEA dt.06.11.2020, vendimi për leje mjedisore me numër reference 5837/19/MEA i dt.06.11.2020, vendimi me numër V_1303_2020 dt. 12.11.2020, vendimi me numër V_1304_2020 dt.12.11.2020, licenca për prodhim të energjisë elektrike nën shenjen ZRRE/Li_49/20 dt.12.11.2020, çertifikata për licencim me numër ZRRE/Li_49/16 dt.12.11.2020, licenca për prodhim të energjisë elektrike nën shenjen ZRRE/Li_50/20 dt.12.11.2020, çertifikata për licencim ZRRE/Li_50/16 dhe ZRRE/Li 50/20 dt.12.11.2020, marrëveshja kontraktuese në mes të K.K. Deçan dhe K..shpk lidhur me shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës së Deçanit dt.16.03.2012, dhe shtojca A e kësaj marrëveshje, vendimi për leje ujore me numër 1839/11-ZSP-69/12 dt.09.02.2012, rekomandimi për ndryshim vendimi dhe vendimi për ndryshim i dt.24.03.2016, vendimi për leje ujore me numër 1839/11-ZSP-69/12 dt.09.02.2012, rekomandimi për ndrydhim të vendimit dhe vendimi për ndryshim me numër 1287/16 –ZSP -356du/2016 dt.24.03.2016, aplikacioni për leje mjedisore i dt.27.09.2019, kërkesa për informata shpeshë dt.12.10.2020, shkresa me titull K.. E.. shpk Hidrocentralet Gjeneruese , vendimi nën shenjen V_1304/2020 dt.12.11.2020, vendimi nën shenjen V_1303_2020 dt.12.11.2020, marrëveshja për blerje të energjisë për kapacitete gjenerues nga burimet e ripërtitshme të energjisë mbështetur nga rregulla për skemën mbështetëse dt.17.01.2018 së bashku me shtojcat përkatëse, vendimi për leje ujore me numër reference 4982/20-ZSP-2020 dt.04.11.2020, artikulli i dt.18.12.2020 i printuar me dt.24.12.2020, artikulli i dt.18.12.2020, i printuar me dt.24.12.2020, raporti vjetor 2019 i ZRRE-së, fatura me numër DE20126387 dt.31.12.2020, artikulli i dt.13.07.2019, peticioni kundër Hidrocentraleve në Lumbardhin e Deçanit pa datë, aktvendimi Gjykatës Komunale në Gjakovë nën shenjen T.nr.95/72 dt.27.10.1975, fleta poseduese me numër 432 i dt.18.09. viti nuk është i qartë, shkresa drejtuar Prokurorit A.. L..pa datë pa numër, njoftimi nga zyra e prokurorit të shtetit PPN.nr.145/19 dt.25.07.2019, çertifikatae njësisë kadastrale P-70505021-00159-0 dt.12.09.2014

si dhe kopja e planit e dt.12.09.2014, shiqohen 3 foto që i referohen viteve 2010-2016, rregullat për licencimeve të aktiviteteve të energjisë në Kosovës dt.31.03.2017, artikulli i dt.13.07.2019, aktvendimi i dt.17.01.2019, shkresa me titull EGU Deçan –Faza e Ndërtimit Versus Objektet e Përfunduara e Nëntorit të vitit 2020 së bashku me foto përcjellëse dhe planimetritë, raporti me rekomandimin exoficio 365/2018 i Avokatit të Popullit dt.03.02.2021, vendimi me numër V_296/2010 dt.11.11.2010, Vendimi V_402_2012 dt.15.06.2012 me autorizimet dhe shtojcat përkatëse, vendimi me numër V_746_2015 dt. 16.07.2015, vendimi V_745_2015 dt. 16.07.2015, Vendimi me numër V_747)_2015 dt.16.07.2015, Vendimi V_748_2015 dt.16.07.2015, Vendimi me numër V_813_2016 dt.19.05.2016, shkresa me titull informatë për ZRRE dt.01.03.2019, shkresa me titull konfirmim dt.26.06.2019, komunikimi elektronik dt. 25.06.2019, vendimi V_1182_2019 dt.14.10.2019, vendimi nr.V_1183_2019 dt.14.10.2019, Vendimi nr.V_1184_2019 dt. 14.10.2019, Licenca për prodhim të energjisë me numër ZRRE/Li_64/18 dt.14.10.2019, së bashku me shtojcat përkatëse, njoftimi me numër 357/20 i dt. 14.10.2020, raporti i grupit punues për shqyrtimin e procedurave administratave të zbatuara për Hidrocentralet i dt. 30.06.2021, Vendimi me numër reference 1839/11 DU /2012 dt. 09.02.2012 dhe vendimi nr.1839/11-ZSP -69/2012 dt.09.02.2012, kërkesa për informata shtesë dt.12.10.2020, Vendimi 5088/20 – ZSP-2021 dt.01.02.2021, Vendimi me numër L.U.7 dt. 01.02.2021, Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese nën shenjë AGJ.2076/22 dt.14.11.2022, Pjesë nga statistikat e ujit në Kosovë e vitit 2017, shkresa me titull EGU BELAJA–Faza e Ndërtimit Versus Objektet e Përfunduara e Nëntorit të vitit 2020 së bashku me foto përcjellëse dhe planimetritë, shpallja publike në Gazetën Express dt.21,10.2010, 23.06.2011, 25.09.2019, 24.06.2011, Raporti i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis i dt. 23.03.2011, Vendimi me numër 11/445/2-ZSP-251/11 dt.08.12.2011, leja urbanistike me numër ZSP -91/2012 dt.16.02.2012 Raporti i Revidimit dt. 16.02.2012, Vendimi 11/445/3-ZSP-41/12 dt.02.03.2012, shkresa me titull: ”Reviser Report 2-Costroktiun Implementation dt.12.04.2012 në gjuhen Angleze, leja e ndërtimit me numër ZSP -321/2012, dt.07.05.2012, Vendimi për leje ujore nr.1839/11-ZSP-129/2013 i dt.19.03.2013, Vendimi për leje Urbanistike me numër ZSP /474/2013 dt.28.05.2013, Shqyrtimi i Kërkesës për leje të ndërtimit me numër ZSP-732/13 dt.09.08.2013, Vendimi për lëshimin e autorizimit me numër V 568_2013 dt. 24.10.2013, Vendimi me numër V_763 2016 dt.28.01.2016, Vendimi me numër V_863_2016 dt.25.11.2016, raporti i revidimit 3L2 dt.15.06.2018, Raporti i revidimit dt.21.06.2019, shkresa në gjuhen angleze me titull ”Instalation Of Eoter Gague HPP Lumbardhi 2 dt. 6-10 gusht 2018, marrëveshja për blerje të energjisë për HC Belaja dt.17.01.2018, dhe HC Deçan 17.01.2018, Marrëveshja në gjuhen angleze Marrëveshja për blerje të energjisë e dt. 16.12.2019, për HPP Lumbardhi 2, Vendimi me numër V_1120_2019 dt.28.03.2019, Vendimi me numër V_1121_2019dt.28.03.2019, Vendimi për leje të përdorimit nr.ZSP-1220/2019 dt.20.09.2019, Vendimi për çertiikatë të përdorimit ZSP-1072/2019 dt.23.08.2019, Mendimi nga AME me nr.4/2020 dt.20.01.2020, vendimi për përfshirje në listë të pritjes dt.18.12.2019, Raporti i aludimit të performancës nga ZKA pa datë, raporti nga monitorimi i ndërmarrjes K.. shpk dt.14.12.2016, Inspektim në bazë të ankesës së Hidro Drinit rreth ndërtimit të HEC-VE Deçan dt.16.05.2014, Raporti nga Amnesty Internaion dt. 28.06.2021, Artikulli i botuar në Gazeten Online Kallxo.com dt. 25.05.2021 i printuar me dt.20.04.2023, Aktvendimi i Gjykatës së Apelit A.nr.230/2021 dt. 15.06.2021, Komunikimi elektronik i dt.27.03.2023, komunikimi elektronik i dt.16.07.2020, Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese me numër reference RK77/10 dt.22.12.20210, shiqohen 45 fotografi të të gjitha

Hidrocentraleve në këtë çështje të Konfliktit Administrativ, mendimi i ekspertit të pavarur Avdi Gjonbalaj dt.20.03.2023, Vendimi për leje ujore me numër 6068/17-ZSP-575 dt.14.06.2018, Rekomandimi për vendim me numër reference 6068/17 dt. 11.06.2018, dhe rekomandimi për leje ujore me të njëjtin numër dhe datë, vendimi për pëlqim ujqor për HC Kaçandolli me numër reference 2941/17 dt.16.10.2020, Rekomandimi për vendim me numër 5180/15 –ZSP-1069/2018, dt.12.09.2018, Lista publike e nxjerr nga Webfaqja e ARPL-së, me lejet ujore të lëshuara sipas viteve pa datë dhe pa numër, publikimet e njoftimit publik për shqyrtim të aplikacioneve për lëshim të licencës për Hidrocentrale data nuk shihet qartë, Vendimi i Këshillit Ndërmnistror për Ujërat me numër KN MU/V /02/2017 dt. 10.01.2018.

Gjykata vendosi në mënyrë meritore në lidhje me aktet administrative të goditura me padi dhe plotësimet e tyre gjatë seancave gjyqësore, e në përputhje me nenin 44, paragrafin 3 të Ligjit për Konfliktet Administrative dhe provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor si dhe përgjigjeve në padi dhe gjeti se padia dhe kërkesëpadija e paditësve është e bazuar.

Gjykata fillimisht vlerësoi pretendimet e paraqitura në përgjigje në padi dhe në seancën e shqyrtimit kryesor në lidhje me legjitimitetin aktiv të palës paditëse në procedurë. Në lidhje me këtë, gjykata gjeti se si paditësi i parë F. S., ashtu edhe paditësit M.L. dhe Xh. K., kanë legjitimitet të plotë aktiv në procedurën e konfliktit administrativ, dhe atë paditësi F. S. si aktivist shoqëror, konsumator i ujit të pijes dhe posedues i tokës bujqësore që varet nga burimi për ujitje dhe përfaqësues i qytetarëve nënshkrues të Peticionit të vitit 2020; paditësi M.L., si pronar i tokës ku është ndërtuar Hidrocentrale Bellaja, me numër parcele 95/1 e që shtrihet në zonën Kadastrale në Isniq, ku babai i paditësit ka trashëguar pjesërisht parcelën me vendim të Gjykatës Komunale në Gjakovë nën shenjë T.nr.95/72 i datës 03.11.1975, i plotëfuqishëm me datë 27.11.1975, si dhe paditësi Xh. K. poashtu pronar i tokës, me Certifikatën e pronësisë Komuna e Deçanit me numër njësie P-70505021-00159-0 e datës 12.09.2014 dhe Kopja e Planit nga kadastru i Komunës së Deçanit, çertifikata nr.P-70505021-00159-0 e datës 12.09.2014.

Gjendja e tillë faktike e legjitimitetit të plotë aktiv të paditësve, është në përputhje të plotë me kërkesat që rrjedhin nga Neni 10 i Ligjit për Nr.03/L-202 për Konfliktet Administrative i cili përcakton: *“Neni 10- 1. Të drejtë për të nisur konfliktin administrativ ka personi fizik si dhe personi juridik, nëse vlerëson se me aktin administrativ përfundimtar në procedurën administrative, i është shkelur ndonjë e drejt apo interes ligjor.*

2. Organi i administratës, Avokati i Popullit, shoqatat dhe organizatat e tjera, të cilat veprojnë në mbrojtje

të interesave publike mund të fillojnë konfliktin administrativ.

3. Organi ka të drejtë të iniciojë konfliktin administrativ, kundër vendimit, që është marrë në bazë të ankesës në procedurën administrative, nëse ai/ajo konsideron se është shkelur ndonjë e drejtë ose interes i tij.

4. Nëse me aktin administrativ është shkelur ligji në favor të personit fizik, personit juridik, konfliktin mund ta iniciojë prokurori publik kompetent ose organi tjetër i autorizuar me ligj. Organet e administratës kanë për detyrë që, kur të kenë mësuar për to, të njoftojnë prokurorin publik kompetent ose organin e autorizuar me ligj.

5.Konfliktin administrativ mund ta iniciojë edhe prokurori publik kompetent ose personi i autorizuar nëse me aktin administrativ është shkelur ligji në dëm të organeve të qeverisjes qendrore dhe të organeve të tjera në varësi të tyre, të organeve të vetëqeverisjes lokale dhe të organeve në varësi të tyre, kur janë shkelur të drejtat pronësore të këtyre organeve”.

Legjitimiteti aktiv i paditësve u vërtetua edhe mbi bazën e nenit 18 të Ligjit për Nr.03/L-202 për Konfliktet Administrative i cili përcakton: *“Neni 18-Paditës në konfliktin administrativ mund të jetë personi fizik, personi juridik, Avokati i Popullit, shoqatat dhe organizatat e tjera, të cilat veprojnë në mbrojtje të interesit publik, që konsideron se me aktin administrativ i është shkelur ndonjë e drejtë apo ndonjë interes i drejtpërdrejtë ose i tërthortë, i bazuar në ligj”.*

Gjykata po ashtu konstatoi se legjitimiteti aktiv i paditësve buron edhe nga neni 6, paragrafi 11 i Ligjit Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, i cili përcakton: *“11. Parimi i mbrojtjes së të drejtave në gjykatë, çdo person juridik ose fizik dhe publiku, në rast të pësimit të dëmit material ose është para një rreziku të pësoj dëm material që ka të bëjë me një aktivitet të veçantë ose burim të ndotjes që bën shkeljen e dispozitave të këtij ligji, ligjeve të veçanta ose akteve nënligjore të nxjerra në bazë të ligjit, ka të drejtë të ngre padi ose të kërkojë nga gjykata kompetente ose autoriteti publik të mbroj të drejtat e veta”.* Në linjë me këtë, gjykata gjeti se edhe ndërhyrësit OJQ “P.” dhe G.. për S.. J.. dhe P.. në përkrahje të paditësve, kanë legjitimitet të plotë për të qenë palë ndërhyrëse në këtë konflikt administrativ në pajtim me nenin 10 dhe 18 të LKA-së dhe nenin 6, paragrafin 11 të LMM-së.

Gjykata shqyrtoi dhe analizoi me kujdes aktet administrative të kontestuara dhe për të njëjtat gjeti se arsyetimi është kontradiktor në raport me dispozitivin e vendimeve dhe Licensave.

Nga vendimet e kontestuara del se ato përmbajnë të meta të tilla të përcjellura me shkelje thelbësore të dispozitave të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative. Shkeljet thelbësore të këtyre dispozitave konsistojnë në faktin se me nenin 47 të këtij ligji është paraparë që akti administrativ, që në këtë rast nënkupton vendimet e goditura me padi të përmbajnë pjesën hyrëse, që tregon emrin e organit publik që ka nxjerrë aktin, bazën ligjore, emrin e atij të cilit i drejtohet akti, shënim të shkurtër të lëndës së procedurës dhe datën e nxjerrjes, pjesën urdhëruese apo dispozitivin, që tregon çfarë është vendosur si dhe afatin, kushtin, detyrimin dhe shpenzimet e procedurës, nëse është i zbatueshëm. Dispozitivi mund të ndahet edhe në më shumë pika. Shpenzimet e procedurës përcaktohen në pikë të veçantë të dispozitivit, pjesën arsyetuese dhe pjesën përmbyllëse, që tregon kohën e hyrjes në fuqi të aktit, informatat për mjetet juridike, përfshirë organin publik apo gjykatën ku paraqitet mjeti juridik administrativ apo gjyqësor, formën e mjetit, afatin përkatës dhe mënyrën e llogaritjes së tij apo këshillën juridike.

Në raport me aktet administrative të kontestuara me padi, gjykata gjeti se në pjesët hyrëse të Vendimit Nr.L.U.13 të datës 03.11.2020, vendimit Nr.L.U.14 të datës 04.11.2020, vendimit 5837/19/MEA të datës 06.11.2020 për HC Belaja, vendimit 5837/19/MEA të datës 06.11.2020 për HC Deçani, organi i paditur nuk kishte paraqitur fare shënim të shkurtër të lëndës së procedurës, ashtu sikurse nuk ka paraqitur emrin e atij që i drejtohet akti, ashtu siç kërkohet me nenin 47, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.1 i Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative. Në po këto akte, në pjesën e Këshillës Juridike, gjykata gjeti se organi i paditur nuk ka respektuar

kushtet ligjore nga neni 47, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.4 i Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, duke mos përcaktuar informacionin se në rast kur ushtrimi i ankesës administrative, sipas ligjit, nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ, pjesa përmblylëse gjithashtu duhet të përmbajë këtë informacion, si dhe bazën ligjore për një përjashtim të tillë.

Tutje, gjykata gjeti se Vendimi i të paditurës së dytë nën shenjë V_1303_2020 i datës 12.11.2020 ashtu edhe vendimi nën shenjë V_1304_2020 i datës 12.11.2020 është marrë poashtu me shkelje ligjore nga neni 47, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.4 i Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, duke mos përcaktuar informacionin se në rast kur ushtrimi i ankesës administrative, sipas ligjit, nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ, pjesa përmblylëse gjithashtu duhet të përmbajë këtë informacion, si dhe bazën ligjore për një përjashtim të tillë. Përveç kësaj, e paditura e dytë, duke qenë në dijeni të plotë se akti administrativ i së njëjtës, paraqet akt përfundimtar në procedurë administrative, ka lëshuar të orientoj qartë palët e interesuara se ndaj këtij vendimi përfundimtar, kompetente për të vlerësuar ligjshmërinë e së njëjtës është Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative. Obligimi i qartësimit se në cilën Gjykatë dhe cilin Departament brenda Gjykatës mund të ngritën pretendimet e palëve të interesuara, po ashtu buron nga neni 9, paragrafi 2 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, në të cilin përcaktohet qartë si në vijim: *“Neni 9-Parimi i administratës së hapur-2. Organi publik duhet të garantojë të drejtën e palës për t’u informuar mbi ecurinë e procedurës administrative, qasjen në dosjen dhe dokumentet e tij dhe të drejtën e njoftimit me mjete të përshtatshme, në pajtim me këtë Ligj”*.

Gjykata poashtu gjeti se në aktet administrative të kundërshtuara në këtë konflikt administrativ, nuk janë dhënë arsye të mjaftueshme mbi bazën e së cilave janë nxjerrë aktet e kontestuara me padi. Në këtë drejtim, të njëjtat nuk janë arsyetuar mbi bazën e kërkesave konkrete që dalin nga neni 48 i Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet: *“Neni 48-Arsyetimi i një akti administrativ me shkrim*

1. Arsyetimi i siguron palës mundësinë që ta kuptojë aktin administrativ. Arsyetimi përmban:

1.1. paraqitje të shkurtër të kërkesës së palës;

1.2. shpjegimin e situatës faktike mbi të cilën është marrë vendimi;

1.3. shkaqet të cilat kanë qenë vendimtare gjatë vlerësimit të provave;

1.4. bazën ligjore të vendimit dhe arsyen pse është e zbatueshme në rastin konkret;

1.5. shkaqet për të cilat nuk është pranuar ndonjëri nga pretendimet e palëve;

1.6. në rastin e ushtrimit të diskrecionit, shpjegimin pse është ushtruar ai në mënyrën e dhënë në vendim.

2. Një arsyetim që është dukshëm i pamjaftueshëm, i paqartë, kundërthënës apo i pakuptueshëm, është i barabartë me mungesën e tij”. Në lidhje me këtë, e duke krahasuar objektin e këtij konflikti administrativ në raport me zbatueshmërinë eventuale të nenit 49 të LPPA-së³ në rastin

³ Neni 49-Panevojshmëria e arsyetimit

1. Arsyetimi i aktit të shkruar nuk është i nevojshëm kur:

1.1. përjashtohet shprehimisht me ligj;

1.2. akti administrativ i nxjerrë, sipas kërkesës, miraton në tërësi kërkesën e palës kërkuese dhe nuk i cenon të drejtat apo interesat juridike të ndonjë pale të tjetër, ose

1.3. akti administrativ i nxjerrë, sipas detyrës zyrtare, nuk cenon të drejtat apo interesat juridike të ndonjë pale.

konkret, gjykata nuk iu prezantua asnjë provë nga organet e paditura apo pala e interesit, mbi bazën e së cilës, aktet e kontestuara me padi, do të mund të përjashtoheshin nga detyrimi për tu arsyetuar.

Arsyetimet e akteve administrative të goditura me padi nuk janë formuluar qartë dhe të njëjtat nuk përfshijnë bazën ligjore dhe faktike të aktit. Nga shqyrtimi dhe vlerësimi i ligjshmërisë së nxjerrjes së Vendimit Nr.L.U.13 të datës 03.11.2020, vendimit Nr.L.U.14 të datës 04.11.2020, vendimit 5837/19/MEA të datës 06.11.2020 për HC Belaja, gjykata gjeti se e paditura e parë ka bërë shkelje direkte të nenit 47, paragrafit 1, nën-paragrafit 1.3. për faktin që në të dy këto akte administrative mungon klauzola e Arsyetimit si element i detyrueshëm i aktit administrativ të shkruar.

Tutje, gjykata gjeti se e paditura e parë me rastin e marrjes së vendimeve kontestuese, përkatësisht të lejes ujqore për HC Deçani, L.U.14, 4982/20 të datës 04.11.2020 dhe Lejes Ujqore për HC Lumbardhi II, L.U. nnumër protokoli 5058/20 e datës 03.02.2021, gabimisht ka zbatuar të drejtën materiale, duke zbatuar nenin 71 të Ligjit Nr.05/L-147 për Ujërat e Kosovës dhe duke i lëshuar Palës së Interesit K..Energy Sh.p.k. në mënyrë të paligjshme Lejet Ujqore për prodhimin e energjisë elektrike. Në këtë drejtim, gjykata gjeti se Lëshimi i lejeve ujqore nga e paditura e parë, për prodhimin e energjisë elektrike, është bërë në kundërshtim me nenin 78, paragrafin 1, 2, 3, nën-paragrafin 3.2 të Ligjit Nr.05/L-147 për Ujërat e Kosovës, në të cilin në mënyrë të qartë përcaktohet si në vijim: *“Neni 78 Veprimtaritë për të cilat ndahet koncesioni për shfrytëzimin e ujërave*

1. Veprimtaritë afariste të cilat realizohen me shfrytëzimin e ujit nga trupat ujqorë sipërfaqësor dhe nëntokësorë, realizohen përmes ndarjes së koncesionit, në pajtim me ligjin.

2. Koncesionin mund ta fitojë personi juridik dhe fizik dhe secili biznes që është i regjistruar në Kosovë.

3. Koncesioni ipet nga Ministria dhe ndahet për:

3.1. shfrytëzimin e ujit për sistemet e ujitjes;

3.2. shfrytëzimin e fuqisë së ujit për prodhimin e energjisë elektrike;

3.3. shfrytëzimin e ujit për nevoja teknologjike;

3.4. shfrytëzimin e ujërave minerale dhe termale;

3.5. mbushjen e ujit në shishe për nevoja komerciale;

3.6. kultivimin e peshqve dhe shpezëve ujqorë;

3.7. ofrimin e shërbimeve turistike, sportive dhe shërbimeve tjera rekreative me ndërtimin e objekteve dhe pajisjeve të përhershme.

4. Koncesioni nuk mund të ndahet, kur me të rrezikohet furnizimi me ujë të pijshëm, bilanci i prodhimit të ushqimit dhe bilancet tjera ekonomike.

5. Lidhur me procedurat për ndarjen e koncesionit si dhe çështjet tjera lidhur me koncesionin, në mënyrë përkatëse zbatohen dispozitat nga ky ligj, përfshirë aktin nënligjor për leje ujqore dhe legjislacionin në fuqi për koncesion.

2. Në rastet e parashikuara në nënparagrafin 1.2 dhe 1.3 të këtij neni, akti mund të përbëhet edhe vetëm nga dispozitivi në formën e shënimit të shkruar mbi kërkesën përkatëse.

6. *Mjetet e realizuara nga ndarja e koncesionit derdhen në Buxhetin e Kosovës*”. Në lidhje me këtë, gjykata gjeti se procedura e fitimit të lejes ujore, mbi bazën e shfrytëzimit të fuqisë së ujit për prodhimin e energjisë elektrike, nuk është bërë në përputhje me nenin 70, paragrafin 1, nën-paragrafin 1.2 dhe paragrafin 3 të Ligjit Nr. Nr.05/L-147 për Ujërat e Kosovës⁴, i cili në ndërlidhje me nenin 78, paragrafin 1, 2, 3, nën-paragrafin 3.2 të po të njëjtit Ligj, ka obliguar të paditurën e parë që në rastet e tilla të zbatohet procedura e koncesionimit, përkatësisht partneritetit publiko-privat, veprime këto që nuk janë marrë, përkatësisht janë anashkaluar nga e paditura e parë e që lëshimi i lejeve ujore duke respektuar procedurën e koncesionimit do të nënkuptonte krijim të kushteve të barabarta për të gjithë operatorët ekonomik e investitorë të brendshëm e të jashtëm që në kushte të barabarta të konkurrojnë në projekte të tilla.

Tutje, gjykata gjeti se në vijimësi të zbatimit jo të drejtë të dispozitave ligjore nga e paditura e parë, konform nenit 16, paragrafit 1, nën-paragrafit 1.1 të Ligjit Nr.03/L-202 për Konfliktet Administrative, e paditura e parë, me vendimet kontestuese, nuk ka arritur të dëshmoj se në rastin konkret Pala e Interesit K..Energy Sh.p.k. ka zbatuar në masën e duhur nenin 34 të Ligjit Nr.03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, në të cilin qartazi përcaktohet si në vijim: “*Neni 34 Masat e rehabilitimit*

1. *Kur konstatohet ose vërtetohet se personi juridik ose fizik apo autoriteti publik ka shkaktuar dëm mjedisor më qëllim ose nga pakujdesia, e cila rezulton me çrregullime mjedisore, është i detyruar ta kthejë pjesën e dëmtuar në kushtet që nuk paraqesin rrezik për mjedisin dhe shëndetin e njeriut apo kapacitetit të përgjithshëm rehabilitues të pjesës së dëmtuar.*

2. *Në rast se personi juridik ose fizik, apo autoriteti publik merr pjesë në një aktivitet të vazhdueshëm që mund të sjell dëm të madh apo kritik mjedisor ose aksident mjedisor, ai ka obligim që në afat të caktuar të ndërmarr masa dhe me aktivitetin e tij në të ardhmen:*

2.1. *të zvogëloj emisionin dhe cilësinë e mjedisit në nivelin e lejuar;*

2.2. *të minimizoj rrezikun për një aksident mjedisor në pajtim me ligjin.*

3. *Personi juridik ose fizik apo autoriteti publik nga i cili kërkohet të ndërmarrë masa nga paragrafi 1. ose 2. i këtij neni, është i detyruar ti paraqes Ministrisë planin për masat që duhet ti ndërmerr.*

4. *Ministria në afat prej tridhjetë ditë duhet t’i përgjigjet palës.*

5. *Në rast se Ministria vlerëson që masat e parapara nga paragrafit 1. dhe 2. të këtij neni nuk janë adekuate, Ministria në afat prej tridhjetë ditëve i kërkon personit juridik ose fizik apo autoritetit publik, modifikimin e planit.*

6. *Në rast se personi juridik ose fizik apo autoriteti publik, konstaton që modifikimet e kërkuara nga Ministria janë të panevojshme dhe tepër të shtrenjta dhe nuk janë në përputhje me paragrafin 1. ose 2. të këtij neni, ka të drejtë ankese.*

7. *Nëse identiteti i palës përgjegjëse për dëmin mjedisor nuk dihet ose në rastet kur personi juridik ose fizik nuk ka mjete financiare të mjaftueshme të sanoj dëmin mjedisor, Qeveria do të jetë përgjegjëse, kur dëmi paraqet rrezik të vazhdueshëm për mjedisin dhe shëndetin e njeriut dhe ajo duhet t’a aprovojë dhe zbatoj një program të arsyeshëm për sanimin e dëmit.*

⁴“*Neni 70 Fitimi dhe kushtet e fitimit të së drejtës ujore 1. Fitimi i së drejtës ujore, sigurohet: 24 1.1. me leje ujore; 1.2. me koncesion. 2. Bartësi i të drejtës ujore shfrytëzon ujin sipas kriterëve të përcaktuara me aktin për fitimin e së drejtës ujore. 3. Koncesioni, përkatësisht partneriteti publik dhe privat kryhet në kushte, mënyra dhe procedura për ndarjen e koncesionit për shfrytëzimin e ujërave të caktuara me këtë ligj dhe legjislacionin në fuqi*”.

8. Në rastet kur, identiteti i palës zbulohet, Qeverisë do ti paguhen mjetet e shpenzuara për rehabilitimin e dëmit.

9. Në rastet kur programi i sanimit përfshinë edhe përgjegjësitë e ministrive tjera kjo ju jep atyre të drejtë që të japin pëlqimet apo propozimet me shkrim brenda tridhjetë (30) ditëve.

10. Për planin e paraqitur në Ministri, publikut i mundësohet qasje për komente në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditë, me që rast komentet duhet të merren në konsideratë.

11. Plani i miratuar është i hapur për publikun”. Në lidhje me këtë, gjykata ju referua edhe Raportit të Avokatit të Popullit me titull: “Raport me Rekomandime-Ex officio 365/2019 kundër Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit lidhur me çështjen e ligjshmërisë së procedurave që kanë të bëjnë me hidrocentralet në vend dhe qasjes në dokumente përkitazi me hidrocentralet”, ku në pikën 65 të këtij Raporti, Avokati i Popullit me të drejtë kishte konstatuar se: “Nga analiza e tërësishme Avokati i Popullit vëren se procesi i licensimit dhe i operimit të hidrocentraleve në vend është përcjellë me mangësi të vazhdueshme sa i përket aspektit procedural tredimensional, qasjes në informata, pjesëmarrjes së publikut në vendimmarrje dhe qasjes në drejtësi. Procesi është përcjellë me mungesë të transparencës së institucioneve përgjegjëse për ligjshmërinë e operimit, e poashtu edhe me paqartësi lidhur me procedurat e organizimit të dëgjimeve publike, si forma të pjesëmarrjes së publikut në vendimmarrje”.

Për më tepër, Lejet mjedisore të lëshuara nga e paditura e parë, janë dhënë në kundërshtim me nenin 34 të Ligjit Nr.03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, me zbatimin e së cilës dispozitë ligjore do të mundësohej rehabilitimi i mjedisit rreth së cilit janë ndërtuar hidrocentralet në fjalë. Në lidhje me këtë, gjykata i fali besimin e plotë Raportit të Grupit Punues për Shqyrtimin e Procedurave administrative të zbatuara për hidrocentralet dhe ndikimin e tyre në ujëra dhe mjedis të 30 Qershorit 2021, ku në pikën 14 të këtij Raporti, në mënyrë decitive konstatohet si në vijim: “Eksplotimi i zhavorrit dhe rërës në lokacionin “Zalli i Rupës” është bërë në kundërshtim me nenin 11 paragrafi 4⁵ dhe neni 128 paragrafi 3 të Ligjit për mbrojtjen e Natyrës në vitin 2010 dhe gjatë vazhdimit të procedurave të lëshimit të akteve tjera administrative nuk është zbatuar neni 10 i UA. Nr. 04/2016 për mbrojtjen e brigjeve të ujërrjedhave”. Sa i përket gjetjes së tillë të eksploatimit të zhavorrit dhe rërës në vendin e quajtur “Zalli i Rupës”, asnjëra nga organet e paditura, duke përfshirë edhe palën e interesit K.. Energy Sh.p.k, as me përgjigjet në padi dhe as gjatë shqyrtimit gjyqësor, nuk arriti të ofroj dëshmi të kundërta para Gjykatës rreth pretendimeve të palës paditëse dhe ndërhyrësve që një eksploatim i tillë i jashtëligjshëm, ka ndodhur. Për këtë qëllim, gjykata detyron të paditurën e parë, që në përputhje me autorizimet e veta ligjore, të mundësoj krijimin e trupave apo mekanizmave *ad-hoc*, mandati i së cilëve do të ishte identifikimi, raportimi dhe sanimi i të gjitha dëmeve mjedisore të shkaktuara nga pala e interesit K.. Energy Sh.p.k. duke përfshirë por duke mos u kufizuar në dëmet mjedisore të shkaktuara në vendin e quajtur “Zalli i Rupës” dhe në të gjitha mjediset tjera, ku është konstatuar shkaktimi i dëmit mjedisor, duke detyruar palën e interesit K.. Energy Sh.p.k. apo cilindo subjekt publik apo privat, që të sanoj apo riparoj të gjitha dëmet e shkaktuara mjedisore të bëra gjatë apo pas ndërtimit të hidrocentraleve. Dëmet mjedisore të shkaktuara nga operimi i hidrocentraleve, gjykata i vërtetoi edhe përmes administrimit në cilësi të provave materiale edhe

⁵ “Neni 4 Interesi i përgjithshëm për mbrojtjen e natyrës- Natyra dhe vlerat e trashëgimisë natyrore janë me interes për Republikën e Kosovës dhe gëzojnë mbrojtje të veçantë”.

të dyzetë e pesë [45] fotografive të dorëzuara si provë nga ana e paditësve dhe ndërhyrësve, me parashtrësën e datës 27.04.2023.

Gjykata refuzoi të gjitha pretendimet e të paditurës së parë se vendimi i atakuar është marrë konform legjislacionit në fuqi, për faktin që e njëjta, as me përgjigjen në padi të datës 24.06.2022 dhe as gjatë shqyrtimit kryesor, gjykatës nuk i ka ofruar as edhe një provë të vetme për të kundërargumentuar ndonjërin nga pretendimet e palës paditëse, ashtu siç kërkohet me nenin 7⁶ të Ligjit Nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore, i zbatueshëm konform nenit 63 të Ligjit Nr. 03/L-202 për Konfliktet Administrative.

Duke marrë parasysh që vendimet e të paditurës së parë janë marrë në mënyrë të kundërligjshme, gjykata gjeti se edhe vendimet e të paditurës së dytë janë marrë me aplikim jo të drejtë të dispozitave ligjore, duke përmbushur kështu të gjitha elementet e nevojshme për tu kundërshtuar dhe rrjedhimisht për tu anuluar, konform nenit 16, paragrafit 1, nën-paragrafit 1.1. të Ligjit për Konfliktet Administrative. Të gjitha vendimet e të paditurës së dytë për licensë mbështeten në lejet ujore dhe mjedisore që janë akte të paligjshme. Në këtë drejtim, gjykata gjeti se lëshimi i licensave nga ana e Zyrës së Rregullatorit për Energji për dyzetë [40] vite, duke u bazuar në nenin 32 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë i cili përcakton: “1. Licenca mund të jepet për periudhën kohore deri në dyzet (40) vjet.”, është interpretim i gabuar ashtu siç është interpretim i përgjithësuar dhe i gabuar i të paditurit të dytë edhe konstatimi se: “ZRRE ka lëshuar licensa të prodhimit për periudhën 40 vjeçare, sepse Licensa është e drejtë për ushtrim të aktiviteteve, në pajtim me kushtet ligjore dhe legjislacionit në fuqi”. Në lidhje me këtë gjykata gjeti se e paditura e dytë gabimisht ka interpretuar dhe zbatuar nenin 32, paragrafin 1 dhe 2.1 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, për faktin që kjo dispozitë ligjore, përcakton vetëm kufirin maksimal të dhënies së lejes në rastet e prodhimit të energjisë elektrike e që afatin maksimal i dhënies së Licensës nuk mund të kalojë 40 vite. Në lidhje me këtë gjykata gjeti se e paditura e dytë, ka dështuar të ndërlidhë afatin për dhënien e Licensës për operim me afatin e vlefshmërisë së Lejes Mjedisore, duke qenë se Leja Mjedisore ishte parakusht formal për dhënien e Licensave nga ZRRE. Në këtë drejtim, argumentet e të paditurës së dytë se Licensa do të revokohej në rast se Operatori Ekonomik nuk do të plotësonte kushtet e Lejes Mjedisore pas kalimit të afatit prej pesë vitesh, u refuzuan si të pabaza. Për më tepër, kohëzgjatja e licensimit nuk mund të tejkalojë asnjëherë afatin të cilin e përmban Leja Mjedisore, pra nga dispozita ligjore që rregullojnë dhënien e lejes për prodhimin e energjisë elektrike, nga ligjvënësi është përcaktuar afati maksimal, e që i është lënë në kompetencë të paditurit të dytë në këtë rast, që për rastet specifike, afati i licensimit të përshtatet me afatin e vlefshmërisë së Lejeve përkatëse të lëshuara nga e paditura e parë dhe jo domosdoshmërisht të vendoset për aftin maksimal të vlefshmërisë prej 40 viteve.

Gjykata poashtu refuzoi pretendimet e të paditurës së dytë me të cilat konsideron se: “Gjykata duhet të marrë parasysh edhe obligimet ligjore të Ligjit Nr.04/L-220 për Investimet e Huaja ku me nenin 3, paragrafi 2 të këtij Ligji, definohet se: “Republika e Kosovës i siguron investitorët

⁶ Neni 7-7.1 Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla.

e huaj dhe investimet e tyre mbrojtje dhe siguri të plotë dhe të vazhdueshme në përputhje me legjislacionin në fuqi”, si pretendime jorelevante për çështjen në fjalë, për faktin që mandati i Gjykatës në këtë konflikt administrativ, është ekskluzivisht vlerësimi i ligjshmërisë së akteve administrative përfundimtare të nxjerra në procedurë administrative nga ana e organeve shtetërore, dhe jo vlerësimi i Ligjit për Investimet e Huaja. Në këtë drejtim, gjykata konstaton se legjislacioni në fuqi i Republikës së Kosovës shërben për të gjithë dhe se të gjithë investitorët, pavarësisht nëse janë të brendshëm apo të huaj, obligohen ti binden rendit ligjor të Republikës së Kosovës.

Në lidhje me vendimin e Këshillit Ndërmnistror për Ujërat me numër KNMU/V/02/2017 të datës 10.01.2018, si provë e prezantuar nga Pala e Interesit K.. Energy Sh.p.k., gjykata konstatoi se me asnjë akt nën-ligjor, duke përfshirë edhe vendimin në fjalë, nuk ka mundur dhe nuk mund të shmanget obligimi ligjor i të paditurës së parë që në rastet e prodhimit të energjisë elektrike duke shfrytëzuar fuqinë e ujit, të zbatohet ekskluzivisht procedura e dhënies së Lejes ujore përmes Koncesionimit, ashtu siç qartazi është përcaktuar me nenin 70, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.2. si dhe me nenin 78, paragrafin 1, 2, 3, nën-paragrafin 3.2 të Ligjit Nr. 04/L-147 Për Ujërat E Kosovës. Rrjedhimisht, krijimi i kuadrit ligjor, respektivisht nxjerrja e akteve nënligjore për procedurën e dhënies së lejes ujore me Koncesionim, ka qenë detyrim *prima facie* i të paditurës së parë, ndërkaq mungesa e kuadrit ligjor, asnjëherë nuk mund të zëvendësohet, të mbulohet apo të arsyetohet duke lëshuar Leje Ujore në kundërshtim me Ligjin Nr. 04/L-147 Për Ujërat E Kosovës.

Gjykata poashtu refuzoi pretendimet e palës së interesit sa i përket Raportit të Grupit Punues për Hidrocentrale, të cilin e përshkruan si: *“perspektivë personale të individëve, e jo artikulum të qartë e profesional të një institucioni të autorizuar për të vlerësuar aktet administrative”*. Në lidhje me këtë, ndonëse vlerësimi i ligjshmërisë së vendimeve të nxjerra nga e paditura e parë, është përgjegjësi ekskluzive e Gjykatës, gjykata vëren se Raporti i Grupit Punues për Shqyrtimin e Procedurave administrative të zbatuara për hidrocentralet dhe ndikimin e tyre në ujëra dhe mjedis, i 30 Qershorit 2021, paraqet dokument kredibil, të besueshëm e të inicuar nga vet e paditura e parë dhe rrjedhimisht, në pikëpamje të gjykatës, pretendimi i palës së interesit se: *“raporti është hartuar nga një organ i cili ligjërisht nuk ekziston”*, është i paqëndrueshëm për faktin që organet qendrore të administratës siç është në rastin konkret Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit, gëzojnë të drejtën ligjore që të themelojnë grupe punuese apo *ad hoc*, me mandat specifik, siç ka ndodhur në rastin konkret me Raportin e Grupit Punues për Shqyrtimin e Procedurave administrative të zbatuara për hidrocentralet dhe ndikimin e tyre në ujëra dhe mjedis të 30 Qershorit 2021, grup ky i cili ka pasur detyrë specifike, me përfundimin e së cilës, pra me përfundimin e raportit, edhe ka pushuar së ekzistuari; megjithatë, operimi i këtij Grupi për një detyrë specifike dhe për një kohë të caktuar ishte i ligjshëm dhe Raporti i nxjerrë ishte kredibil.

Gjykata hodhi poshtë pretendimet e Palës së interesit K.. Energy Sh.p.k. të shprehura përmes parashtrësës së datës 26.04.2023 në të cilën thuhet se Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor ka lëshuar Leje Ujore edhe për Shoqëri tjera tregtare të cilat aktivitet kryesor kanë prodhimin e energjisë elektrike e të cilat janë lëshuar pa koncesion. Në lidhje me këtë, gjykata erdhi në përfundim se: së pari, meqenëse Lejet Ujore të cilave Pala e Interesuar ju është referuar

në këtë parashtrësë, nuk ishin objekt shqyrtimi në këtë konflikt administrativ dhe si të tilla, ligjshmëria e tyre nuk mund të vlerësohet nga gjykata e rrjedhimisht as të komentohen. Së dyti, gjykata gjen se lëshimi i Lejeve Ujore për operimin e hidrocentraleve të tjera, nuk mund të shërbej si argument për të arsyetuar kundërligjshmërinë e akteve administrative të goditura në këtë konflikt administrativ, ashtu siç nuk mund të shërbej si argument praktika e tillë e ndërtuar në mënyrë të jashtëligjshme.

Gjykata nuk mori parasysh vlerësimin e pretendimeve të palës paditëse për shkelje të pretenduar të nenit 7.1, nenit 52 nga Kapitulli II, nenit 119, 121 dhe 122 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke qenë se vlerësimi i pretendimeve për shkelje kushtetuese nga organet shtetërore, është në jurisdiksion ekskluziv të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës.

Në lidhje me vendimin për shpenzimet procedurale, u vendos konform nenit 64 të Ligjit për Konfliktet Administrative.

Në bazë të asaj që u tha më lartë e në kuptim të nenit 5, 6, 38, 43, paragrafit 3, nenit 46, paragrafi 1, 2, 3, 4 dhe 5 të Ligjit për Konfliktet Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti për Çështje Administrative
A.nr.2081/20, datë 22.05.2023

G j y q t a r i

Kreshnik Kaçiu

Këshillë Juridike: Kundër këtij Aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.